

Besjana, e mbijetuara: Parandjeva aksidentin

Lezha dhe Elbasani, më shumë anaflabetë

Zbulohet fotoja e rrallë e shkrimtarit Ernest Koliqi

Murinjo shkarkohet për herë të parë nga një klub

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI III - NR. 117 E martë, 21-05-2013

Toner Taxi

22 53 770

Bojra printeri -50% më lirë
www.tonertaxi.info

PARALAJMERIMI I IRANIT

Çfarë deklarojnë zyrtarët e Ministrisë së Jashtme dhe të Brendshme FRIKA NGA MUXHAHEDINET JA REAGIMI I QEVERISE

Dy ministritë shqiptare ia përcjellin njëra-tjetrës detyrën për të mbajtur një qëndrim për paralajmërimet se muxhahedinët në Shqipëri kërcënojnë sigurinë kombëtare ▶ Faqe 10

KONVENTA E RAMES ▶ Faqe 4



Hervin Çuli:
Çfarë thonë
ngjyrat dhe
daulet e PS

META NE FIER ▶ Faqe 6



**Opozita e
bashkuar merr
80 deputetë
në zgjedhje**

SUPERBANDA ▶ Faqe 12



Zbulohen fotot e trafikantëve të drogës
34 persona u arrestuan në Shqipëri dhe në Evropë

Koment



NGA **PREÇ ZOGAJ**

Fushata si armike e së majtës

Të dielën pasdite kundërhënie dhe skulpturë në kampin e majtë shënuan një koktel të pazakontë, aq sa një vëshgues i hollë i jetës politike në vend, bastvënës pa zemër i rrotacionit, u dëgjua t'u thoshte miqve të tij socialistë një frazë lapidare, ngjyer me humor të zi dhe dëshpërim. Frazja ishte: "I vetmi shans që kemi për të shpresuar fitoren është të ndalim fushatën". Çfarë kishte ndodhur? Në një anë shija intelektuale dhe ajo popullore ishin bombarduar me konventën e prezantimeve historike të kandidatëve dhe aleatëve të PS-së, ku njohja dhe merita mbyteshin pamëshirshëm në anoniminat numerikisht sundues të atij mjedisi dhe ku Edi Rama, në një akt tjetër të talljes krijuese, kishte rrembyer nga panteoni kombëtar portretet e korifenjve të kulturës për t'i përdorur si stoli në sfondin e paradës së tij mediokre, deri analfabete, të cilën kishte guxim dhe kënaqësinë ta paraqiste si skuadër kombëtare të rilindjes kombëtare! Konventa e prezantimeve historike ishte e shëmtuar jo vetëm për këtë shkak. Më kujtohet, vite më parë, Teatri i Tiranës, në fund të një festivali mëtoi të imitonte ceremoninë e ndarjes së çmimeve Oskar. Gjithçka dukej si... ▶ vijon në faqe 14

DEBATI

“Molla e sherrit”, kolltuku i Berishës

Ish-kryeministri: Të heqim Saliun. Kryeministri: Meta do karrigen time.
Kandidati për kryeministër: Këtë e zgjidh Kushtetuta. Forumi, flasin politikanët



TIRANE

JAKIN MARENA

Deklarata e njërit prej drejtuesve të LSI, Nasip Naço në Berat se Ilir Meta pas 23 qershorit do të jetë kryeministër i vendit ka sjellë një debat të fortë në politikën shqiptare. Ditën e djeshme s'kanë munguar të pozicionohen publikisht dhe krerët e dy partive të majta, Edi Rama e Ilir Meta, që e kanë cilësuar diversion të Berishës dhe një ëndërr të tij për të parë të majtën të përçarë pasi për Kryeministrin vendos... ▶ Faqe 2-3

DITA E JETIMEVE ▶ Faqe 16-17

Fshati SOS drejt mbylljes?

Historia e 9-vjeçarit jetim



NERANXI

... gjithmonë një hap përpara...

Lëndë të para për restorante,
piceri, kreperi dhe fast food.



Kandidatët e PDIU, Idrizi: Fushata me kartën e vlerave

Shpëtim Idrizi prezanton 140 kandidatët për deputetë të Partisë për Drejtësi, Integritim dhe Unitet dhe bëri të ditur se ata do të bëjnë fushatë me "kartën e vlerës". "Ne mendojmë se politika duhet të jetë në shërbim të qytetarëve, e jo qytetarët në shërbim të politikës. Pyetja është: A do ta ndërtojmë këtë vend së bashku, apo do të lejojmë që ta

ndërtojnë gjithmonë nga e para fitimtarët e rradhës? Ky është viti i parë i 100 vjetorit të dytë, i Pavarësisë së Shqipërisë, e ne ende nuk e kemi të qartë nëse kemi festuar 100 vjetorin e shtetit shqiptar apo kemi lënguar në 100 vjet tranzicion. Ne besojmë sidomos tek rinia shqiptare ndaj i drejtohem brezit të ri, se pasioni e angazhimi juaj do të jenë vendimtare,

nëse ne do të ndërtojmë një shoqëri ku progresi është shërbëtori i nevojave tonë", tha Idrizi. I cili ka nënvizuar faktin se çështja që ata mbrojnë, ajo çame nuk është thjeshtë e tyre por e gjithë popullit shqiptar. Ai ka nënvizuar faktin se nga pozicioni i një partie të vlerave kërkon dhe votën e shqiptarëve, duke besuar në një mbështetje masive.

Kryeministri, kreu i PS e i LSI: Respektojmë paktin Rama-Meta: Është diversion i Berishës

Rama: Vendos Kushtetuta. Meta: Personale

Lajmi

Kryetari i PS Edi Rama dhe kreu i LSI Ilir Meta kanë deklaruar se koalicionin mes dy partive është solid dhe në sintoni të plotë. Ata shprehën se diversioni i Berishës që ka dhënë rezultat në të kaluarën, s'funksionin. Ata thanë se Berisha është i lirë të ndërrojë.



Edi Rama dhe Ilir Meta

Akuzat

"S'di të fitojë pa vjedhur s'di të qeverise pa vjedhur s'di të ikë ndryshe veçse duke iu përvjedhur të vërtetave të hidhura të keqkëqerjes! Do gënjejë dhe një muaj e do ikë si gënjeshtari më i madh që shqiptarët patën ndonjëherë mbi krye! 23 qershor, vota e ndëshkimit, e Rilindjes", tha Rama.

diferenca është aq e thellë sa s'mund të zhvatë fitoren.

META

Kryetari i LSI Ilir Meta e cilësoi si një dëshirë individuale deklaratën e deputetit Nasip Naço në Berat, që ftoi qytetarët të votojnë LSI për të bërë liderin e saj kryeministër. "Objektivi kryesor është fitorja e Aleancës për Shqipërinë Evropiane në 23 qershor dhe njëkohësisht arritja e një rezultati historik e i tillë do jetë për LSI. Lidhur me deklaratat të caktuara mendoj se ato nuk na shmangin nga objektivat kryesore që ne kemi e njëkohësisht sikurse u konfirmua dhe dhe nga PS, koalicioni është në një sintoni të plotë dhe me një rritje të jashtëzakonshme të frymës së bashkëpunimit, që thellon çdo ditë fitoren e 23 qershorit. Koalicioni i majtë ka një objektivi të vetëm që është fitorja plebishitare dhe është në sintoni të plotë. Të tjerat janë deklaratat dhe dëshira të individëve të caktuar. Ashtu si dhe zoti Berisha ka ëndrrat e tij dhe vazhdon të shikojë ëndrra me sy hapur. Objektivi im i vetëm është fitorja e së majtës. Me PS kemi një mendë dakord që do të mos jetë më kryeministër", u shpreh Meta. Ai akuzoi Berishën për diversion. "Diversionet e tij brenda të majtës, apo brenda opozitës nuk kanë më asnjë të ardhshme. Ai arriti të qëndrojë për një kohë të gjatë në pushtet, falë problemeve. Fillon një epokë e re në mëngjesin e 24 qershorit", deklaroi Meta, duke mohuar përçarjet në koalicion.

Berisha:

"Meta s'merr kurrë karrigen time, ai synon kreun e PS"

Kreu i mazhorancës, Sali Berisha gjatë takimit me gazetarët në Gjirokastrë nuk ka qëndruar pa bërë diversion, duke thënë se Meta kërkojë karrigen e tij, ndërsa meqenëse nuk e mori, kërkon që të marrë drejtësinë e PS. Njëherësh nuk ka lënë pa sulmuar dhe kreun e PS Edi Rama. "Çdo gjë janë po opozitarë nuk janë. Rama ka qenë personi i dytë më i rëndësishëm në fuqinë ekzekutive të vendit, kryetari i Bashkisë së Tiranës. Meta ishte 4 vjet zv/kryeministër. Por ai synon ose të marrë kreun e PS-së, ose të marrë karrigen time, të cilën nuk do ta marrë dot kurrë", tha Berisha, në përpjekje për të bërë një diversion të hapur në drejtim të së majtës shqiptare. I pyetur nëse do të bënte një koalicion me Metën pas zgjedhjeve të 23 qershorit nëse këtë do ta impononin numrat, ai ka këmbëngulur sërisht duke thënë se synimi i kreu të LSI është të bëhet kryeministër por këtë nuk e arrin dot. "Ambicia e tij është kreu i Partisë Socialiste por ajo nuk më intereson. Ambicia e tij është se si të rregullojë numrat për t'u bërë kryeministër,



Sali Berisha

aty e ka të pamundur", tha Berisha. Por nga ana tjetër kreu i mazhorancës Berisha teksa ka përmendur sërisht deklaratat e Metës dhe të Ramës në lidhje me paktin e tyre dhe për integritimin e vendit, ai hedhur dyshimin nëse lideri i LSI e ka me të vërtetë këtë qëllim ose jo, pasi sipas tij tërë qëllimi i afrimit me PS ka qenë marrja e kryesimit të kësaj partie dhe i së majtës. Njëherësh ai ka nënvizuar se nëse e kanë seriozitet votimin e tre ligjeve ai është gati të votojë që nesër. Berisha është shquar për diversion brenda së majtës, e kjo ka funksionuar për gjatë gjithë këtyre 8 viteve, duke qëndruar në pushtet falë tij.

TIRANE

JAKIN MARENA

Deklarata e njerit prej drejtuesve të LSI, Nasip Naço në Berat se Ilir Meta pas 23 qershorit do të jetë kryeministër i vendit ka sjellë një debat të fortë në politikën shqiptare. Ditën e djeshme s'kanë munguar të pozicionohen publikisht dhe krerët e dy partive të majta, Edi Rama e Ilir Meta, që e kanë cilësuar diversion të Berishës dhe një ëndërr të tij për të parë të majtën të përçarë pasi për Kryeministrin vendos Kushtetuta dhe se respektohet marrëveshja mes dy partive, duke menaxhuar rezultatit e thellë.

RAMA

Kreu i PS Edi Rama ka qenë më se i qartë në deklarinë e tij në lidhje me deklaratën e Naços se Meta do të jetë kryeministër, kur ka thënë se kush do jetë kryeministri pas fitores së opozitës e përcahton Kushtetuta. "Të jeni të sigurt se asnjë lloj diversioni mbi fjalime apo fjali të thëna mes entuziazmit të fushatës elektorale nuk funksionon. Aleanca është kompakte, PS është në sintoni dhe sinkronizim me LSI dhe aleatët e tjerë dhe mos kini merakun më të vogël se kush do jetë kryeministri pas fitores është gjëja më e thjeshtë dhe më e shpejtë për

Naço në Berat:

"Ilir Meta, kryeministri i ri pas fitores së 23 qershorit"

Gjatë mitingut për prezantimin e kandidatëve për deputetë në qarkun e Beratit, një prej figurave të LSI Nasip Naço tha se: "E majta e bashkuar do t'i fitojë zgjedhjet për t'i dhënë vendit një stabilitet të ri, një rotacion politik, një ekuilibër të ri të institucioneve të pavarura, larg kontrollit të një njeriu të vetëm. LSI është forca që do ta realizojë këtë ndryshim, pasi ne kemi një lidhshmëri të prodhuar në këto vite, që di t'i fitojë zgjedhjet, por edhe t'i mbrojë ato. Ai është kryeministri më i suksesshëm i së majtës në Shqipëri, është lideri i së majtës, ai është Ilir Meta". Por ai ka shtuar akoma më tej, teksa e ka ripërsëritur deklaratën. "Të gjithë ne që jemi këtu bashkë, kemi të



Nasip Naço

përbashkët Malin e Tomorit por sigurisht që të gjithë ne bashkë kemi e një mal të politikës shqiptare. Ai është Ilir Meta, që, me votën tuaj në 23 qershor do jetë Kryeministri i Shqipërisë e ai do të bëjë më shumë se gjithë kryeministrat e tjerë, sepse është djali juaj, ai ka lindur në këtë qark dhe do të bëjë realitet të gjitha premtimet", u shpreh Naço.

t'u zgjidhur, bazuar në çfarë thotë Kushtetuta dhe vullneti i popullit. Në këtë pikë më vjen keq, por nuk keni çfarë peshkoni se Saliu ka mbetur pas ngjajave dhe i duhet të

peshkojë, por fatkeqësisht po peshkon në tokë të thatë", deklaroi Rama, në përgjigje të interesit të gazetarëve. Duke nënvizuar se sondazhet thonë se sado të vjetër Berisha,



**Ligji i pronave,
Mediu: Kërkojmë
ekspertizë nga BE**

Nga Vlorë ku prezantoi kandidatët e Partisë Republikane për këtë qark, Fatmir Mediu akuzoi kryetarin e PS Edi Rama për qëndrimet e tij ndaj pronës dhe pronarëve. Sipas Mediu Partia Republikane do të kërkojë ekspertizë ligjore nga BE për rregullimin e legjislacionit shqiptar mbi pronën. "Edi Rama premtoi në një takim këtu në Vlorë që toka i takon atij që e punon, dhe

do tu japë tapitë atyre që e kanë punuar për 20 vjet. Jo motra dhe vëllezër, toka i takon atij që e ka trashëguar dhe e ka përfutur në mënyrë të ligjshme, sipas asaj që është përcaktuar në Kushtetutë, dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Prandaj, PR ka vendosur që së shpejti të kërkojë ekspertizën evropiane nga KE dhe PE, në mënyrë që të vlerësojmë të gjithë legjislacionin për pronën dhe të japim

zgjidhje kësaj çështje", tha Mediu. Ndërkohë që kreu i Partisë Republikane Mediu është zotuar se brenda këtij mandati të tretë qeverisës të mazhorancës së djathtë, që sipas tij do të rikonfirmohet pas zgjedhjeve të 23 qershorit, çështja e pronave do të marrë udhën e zgjidhjes përfundimtare, pasi është dhe kush për integrimin e Shqipërisë në bashkimin Evropian.



Ilir Meta kryeministër, flasin Ngjela, Milo, Ndoka, Shehi dhe Koçi

Të vegjlit e PS-PD: Kthim tek djajtë e së kaluarës

Opozita: Emocionale. Mazhoranca: Meta do kreun e PS

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

Urrat e qeta në marrëdhëniet mes PS dhe LSI, dhe më konkretisht mes Ramës dhe Metës janë turbulluar shumë këto ditë e fundit. Ka mjaftuar vetëm një deklaratë në dukje emocionale e deputetit të LSI Nasip Naço, në mitingun e Beratit teksa Meta kishte shkuar aty për të prezantuar kandidatët për deputetë të këtij qarku, që të ringjallen debatet e hershme dhe ngërçuese se kush nga liderët e majtë do të marrë postin e kryeministrit, në rastin e një fitoreje të mundshme në zgjedhjet e 23 qershorit. Naço nuk tha as më pak dhe as më shumë, por në prezencë të Metës deklaroi se lideri i LSI do të jetë kreu i qeverisë së pas 23 qershorit. Pas qëndrimeve të Ramës dhe Metës që e cilësuan përdorimin e kësaj deklaratë të thënë në një miting elektoral nga Berisha si një diversion brenda së majtës, kanë folur dhe krerët e partive të vogla në të dy krahët e spektrit politik shqiptar. Janë pronomuar krerët e partive aleate të PD, përkatësisht Nard Ndoka kryetar i PDK dhe Dashamir Shehi kryetar i LZHK. Ndoka ka thënë se opozita nuk po arrin dot që të kthehet në një alternativë qeverisëse, ndërkohë që sipas tij Meta, teksa ka parë se e majta do të humbë, do tentojë të marrë kreun e PS. Ndërsa Shehi thotë se më mirë që e filluan tani sherrin se sa pas zgjedhjeve dhe se ky do të jetë dhe sherr kryesor të e majta shqiptare. Duke bërë thirrje ndaj shqiptarëve që të shohin se kush është e opozita. Nga ana e tyre krerët e partive aleate të PS, përkatësisht Paskal Milo kreu i PDS, Spartak Ngjela kreu i PLD dhe Petro Koçi, kreu i PSV '91 janë shprehur se deklarata të tilla, pavarësisht se janë të dëmshme në fushatë, nuk tregojnë çarje mes aleatëve, pasi të dy krerët e PS dhe LSI janë shprehur se do të respektojnë marrëveshjen mes tyre të nënshkruar në Shkodër.



Nard Ndoka




Paskal Milo



Spartak Ngjela



Dashamir Shehi



Shehi

Me mirë që e filluan tani këtë "sherr" sesa ta fillonin pas zgjedhjeve, pasi ky ka qënë, është dhe do të jetë një debat i përhershëm në radhët e të majtës shqiptare.



Petro Koçi

kërkon kryeministrin, në rastin më të keq dhe atë që do të ndodhë, kërkon të marrë drejtimin e PS pas humbjes. Opozita po humb terren në raport me vetveten, me qytetarët dhe ndërkombëtarët. Përjashtimi i disa deputetëve socialistë nga kandidimi, lënia jashtë e liderit historik Nano, dalja e kandidatëve të pavarur, e tregon këtë turrje të PS.

SPARTAK NGJELA, KRYETARI I PLD:

Janë deklarata personale të Nasip Naços. Ne nuk mund të komentojmë deklaratat personale të tij. Rama dhe Meta përkatësisht kryetari i PS dhe i LSI kanë bërë një marrëveshje mes tyre dhe kanë deklaruar e janë zotuar se do ta zbatojnë këtë marrëveshje. Unë mendoj se ata do ta zbatojnë këtë pakt mes tyre, pasi më shumë rëndësi siç e kanë dhe deklaruar ka fitorja e opozitës më 23 qershor dhe largimi i Berishës.

DASHAMIR SHEHI, KRYETARI I LZHK:

Me mirë që e filluan tani këtë "sherr" sesa ta fillonin pas zgjedhjeve, pasi ky ka qënë, është dhe do të jetë një debat i përhershëm në radhët e të majtës shqiptare. Por e mira e kësaj

PETRO KOÇI, KRYETARI I PSV '91:

Kjo është një çështje që nuk ka pikëpyetje. Kryeministri i takon partisë fituese të zgjedhjeve. Nuk duhen keqkuptuar dëshirat njerëzve të caktuar në LSI, por kjo është një çështje që zgjidhet, janë standarde politike tashmë të provuara nga vende të qytetëruara. Pavarësisht rritjes që mund të ketë LSI në mandate parlamentare, numrat e saj do të jenë të pamundur për këtë lloj vendimi. Sepse partia e parë brenda koalicionit është PS dhe është ajo që e cakton kryeministrin. Mendoj se fushata elektorale e opozitës nuk ka nevojë për këtë lloj debati, që turbullojnë kohezionin elektoral të saj.

e koalicionit. Urojme që lokomotiva e Ramës të ketë fuqinë e nevojshme për të mos e lënë trenin e opozitës në rrugë. Programi ynë është më pranë shtresave të varfra e në nevojë dhe këtu mund të përmend dhe një propozim konkret për minatorët.

NARD NDOKA, KRYETARI I PDK:

Deklarata e njerit prej figurave kryesore të LSI për Metën kryeministër pas zgjedhjeve, tregon se kjo është një opozitë me probleme. Mendoj se po vijojnë problemet që kanë pasur gjithnjë dhe për më tepër që kanë filluar të bëjnë llogaritë ende pa u bërë zgjedhjet, kur ato janë në humbje për opozitën. Në këtë këndvështrim, opozita nuk po arrin

Nasip Naço nuk tha as më pak dhe as më shumë, por në prezencë të Metës deklaroi se lideri i LSI do të jetë kreu i qeverisë së pas 23 qershorit

te kthehet në alternative qeverisëse. Ka përjashtuar aleatët nga parlamenti dhe ka mbetur me një parti që vetëm aleatë nuk mund të jetë. Në rastin më të mirë

? PYETJE PERGJIGJE

■ Pse shkaktoi kaq debate deklarata e Nasip Naços në mitingun e LSI në Berat që, pas 23 qershorit Ilir Meta do jetë kryeministër?
Debati është shkaktuar për shkak se tek e majta ka qënë gjithnjë një mollë sherr mes Ramës dhe Metës se kush do të jetë kreu i qeverisë pas një fitoreje të mundshme. Madje thuhet se pikërisht mosarritja e një akordi të tillë mes Ramës dhe Metës, që ky i fundit të ishte kryeministër, ndërsa Rama të mbante kreun e bashkisë së Tiranës solli dhe ndarjen në zgjedhjet e 2009, fati i të cilave dihet tashmë.

■ Një deklaratë e tillë në fillim të fushatës çfarë sjell..?
Në prag të fushatës elektorale një deklaratë e tillë që krijon idenë se ende e majta është larg arritjes së konsensusit për kreun e qeverisë, pra s'di çfarë të bëjë me fitoren e mundshme të 23 qershorit, sjell mosbesim dhe hutim tek elektorati. Ndaj dhe Rama e Meta janë munduar dije të qetësojnë situatën, duke deklaruar se koalicioni është solid dhe se janë në simtoni të plotë në funksion të fitores së madhe sipas tyre të zgjedhjeve të 23 qershorit, dhe largimit të Berishës nga pushteti.



**PD, në Gjirokastrë:
Famoz i Caci i dha lekë
Ramës për të genë në listë**

Partia Demokratike çeli fushatën zgjedhore në Qarkun e Gjirokastrës, ku kreu i kësaj partie Sali Berisha prezantoi edhe kandidatët për deputetë, ku u shpreh i sigurt se ka sjellë edhe në këtë shesh "Uraganin e fitores". Duke vlerësuar punën e ministrave Ruli e Ksera si të zgjedhurit e Gjirokastrës, Berisha akuzoi kandidatët e PS-së në këtë qytet. Sipas tij, ata janë njerëz që pounjë për të mbushur

xhepat e tyre. "Na takon neve regjistrimi në UNESKO si pasuri e kulturës botërore. Kam kënaqësinë t'ju informoj se çdo projekt për hyrjen e Gjirokastrës, për lumin e Drinos apo qendrën e qytetit, për shkollat, vaditjen e fermerët kanë patur angazhimin e plotë dhe total të përfaqësuesve tuaj, ministrave Genc Ruli dhe Spiro Ksera. Dy fjalë do t'ju them për biznesmenët e Edi Ramës. Së pari të

marrim famozin Cacin, ai në mënyrë absolute përveç parave që i ka dhënë Ramës për tu vendosur në listë s'ka asgjë të përbashkët me ju. Në rast se ju i kërkonit njeri-tjetrit t'ju bënte një zile dikur se ju mbaronte krediti në celular Arben Hermis vidhte në mënyrën më të papërbajtur Telekomin shqiptar. Këta janë kandidatët e Ramës por le të shohim përpara", vijoi ai.

Lajmi
Kryeministri nga Gjirokastra akuzoi kreun e opozitës se ka bërë pazare për minoritetit grek, duke përmendur këtu edhe largimin e ish-anëtarit të KQZ, Jani Jani. Ndër të tjera ai foli edhe për investimet në Gjirokastrë si dhe gadishmërinë për të votuar 3 ligjet.

TIRANE

ARTEMISA HOXHA



Reon Dule
Kreu i PBDNJ-së, Vangjel Dule, reagoi pas akuzave të kryeministrit Berisha ndaj tij në Gjirokastrë, për pazare me fatet e minoritetit. "Prisnim nga Kryeministri në kuadër të vizitës së tij në Gjirokastrë përgjigje për disa çështje konkrete që preokupojnë komunitetin e zonës dhe minoritetin etnik grek. Kryeministri i është bërë obsesion ideja e ekzistencës së pazareve politike jo transparente. Produktin e një pazari të tillë në vitin 2009 me synim dëmtimin e PBDNJ-së e kishte sot në krah", tha Dule.

NË FOTO: Berisha me gazetarët në Gjirokastrë

i ka thënë presidenti austriak vetes. Imagino ti se çfarë ka menduar ai për një politikan shqiptar që bëri një veprim të tillë. Dhe ai zotëria e ka shndërruar fushatën e tij në fushatën e shkulljes së veshit. Shkon nga tubimi në tubim dhe u thotë më shkulli veshin. Ajo mendje që kapi për veshi diplomatit, ajo mendje i thotë t'u thotë shqiptarëve që janë të izoluar. Sa i takon takimit me Svobodën. Disa prej këtyre zotërinjve që erdhën në Tiranë dhe bënë deklarata, sot po shkruajnë kujtimet në qelqitë e burgut për korrupsion. Për mua çdo lloj vlerësimi për politikanët shqiptar është vlerësim, por kur bëhen deklarata me pagesë, ato nuk kanë asnjë vlerë. Nëse doni deklarata për Sali Berishën, unë mund të mblehd 5 qdo ditë, por unë merrem me qytetarët.

Kryeministri flet me gazetarët në Gjirokastrë

Berisha: Rama pagoi Svobodën

Pazare me Dulen për minoritetin, Tavo plaçkë tregu

Kryeministri Berisha deklaroi në Gjirokastrë se është i gatshëm të mblehdë që nesër parlamentin për të votuar 3 ligjet e konsideruara si çelësi për marrjen e statusit kandidat për në BE. Ai akuzoi Ramën se ka paguar për deklaratat pro tij.

Zoti Rama ka deklaruar se është i gatshëm të votojë 3 ligjet. A do të jeni ju i gatshëm ta pranonit të mblidhni Parlamentin? Ai thotë se e bën këtë sipas propozimit të zotit Meta.

Pasi bënë dëmin e madh, u garantuan se statusi nuk merret. Tani ndjehen të lehtësuar. Zoti Rama duhet tu kërkojë 220 herë të falur për çdo ditë që nuk i votoi, duke u bërë një dëm kolosal. Duke privuar vendin nga një pasaportë ditëjiti. Një njeri i përgjegjshëm që merr kthesën, se pendesa është njerëzore, pendohesh

Sa i takon takimit me Svobodën. Disa prej këtyre zotërinjve që erdhën në Tiranë dhe bënë deklarata, sot po shkruajnë kujtimet në qelqitë e burgut për korrupsion

dhe duhet të thuash u pendova. Por të kesh pendesën. Ata që lexojnë në doktrina psikologjike, ata do gjejnë se pendesa është një dukuri më e vonshme tek homosapiens, sesa kompleksi i turpit. Është e një stadi më të lartë pendesa. Në qoftë se zoti Rama e ka seriozisht këtë zotim solem, parlamenti mblidhet menjëherë. I kërkoj zotit Rama të votojmë amnistinë për biznesin. Qytetarëve shqiptarë u garantoj se amnistia nuk do të përfshijë asnjë politikan në mënyrë kategorike dhe

familjare të politikanëve. Ta shoytojë me seriozitet sepse biznesi e meriton këtë. Shteti dënon, shteti fal. Uroj të mos kenë bërë tregti për ndonjë gjë më shumë, se ja paska mbushur mendjen Meta. Do t'i kërkoj kryetares se parlamentit ose deputetëve të mi të mblidhemi t'i votojmë që nesër. Drejtori i përgjithshëm i zgjerimit në BE, Sannino ka bërë një punë të jashtëzakonshme për tu arritur ujdia. Ai sajoi Fierin. Ç'është Fieri, një grup këshilltarësh të PS kaluan me LSI, me të drejtën e tyre. Ai që mallkonte këshilltarët tani mori Ilirin. Prap vetëm tani që e sheh, barra po rëndon në mënyrë të tmerrshme mbi të, mendon se do mund tu thotë qytetarëve ç'më duhet mua se ç'bëra unë. Atë s'mund ta thuash, se u ke bërë një dëm personal çdo qytetari shqiptar.

Minoritetet, kandidatët për deputetë që do t'i përfaqësojnë...

Në këto zgjedhje ka një situatë të veçantë minoriteti. Janë përpjekur që ta fragmentojnë. Çfarë ndodhi, PBDNJ,

një parti e respektuar nga unë, bëri një gabim shumë të rëndë, sepse hyri në politikën e pazareve. Marrim partinë e zotit Vangjel, kam pasur respekt, por pazaret që bën, janë shumë të padejta. Kishte një

përfaqësues në KQZ, i bënte nder komisionit, sepse në fund të fundit ishte një përfaqësues i juaj. E detyruan, e terrorizuan për pazaret që bënte me Ramën dhe në fund Rama i mashtroi dhe Jani

Jani u nxor nga komisioni. Pastaj u sollën Caçin, por atij nuk i shkon mendja tek minoriteti. Marr Vangjel Tavon, akti i parë, Edi Rama e futi në listën e zezë. Ju keni këtu një njeri tuaj, birin tuaj, që mbetet avokat i pamposhtur i të drejtave të minoritetit, ky është ministri Ksera. Ai është promotori i çdo projekti në zonat e minoritetit. Ai është një ministër i përkushtuar. Këtu vjen për minoritet Caci, i famshmi. Zoti Vangjel Tavo, plaçkë tregu. Pse? Sepse sapo zoti Meta kaloi tek zoti Rama, të nesërmen ju dorëzua lista e zezë nga zoti Rama. Lista e zezë ishte kjo që këta persona nuk mund të vinë në PS. Lista filonte me Tavon, armiku i PS Vangjel Tavo.

Kreu i PS është takuar me lider politik, ku mes tyre dhe zotin Ficher...

Lajmi u dha, por foto nuk kishte. Nëse Rama është takuar me presidentin Fischer dhe pasi ka dalë nga zyra kapi prej veshi një diplomat të ri, imagjino ti çfarë

Problematika përsa i përket topinimeve të pasaportave?

Po negociojmë non stop. Jemi plotësisht të vendosur të zbatojmë ligjin ndërkombëtar në marrëdhënie me Greqinë. Nuk besoj se ka asnjë lloj vështirësie edhe për palën greke.

Aeroporti i Gjirokastrës është akoma jo-funksional, ndërkohë që bashkia pretendon se nuk

Pastaj u sollën Cacin, por atij nuk i shkon mendja tek minoriteti. Marr Vangjel Tavon, akti i parë, Edi Rama e futi në listën e zezë. Ju keni këtu birin tuaj, ky është ministri Ksera.

ka fonde të mjaftueshme për realizimin e tij, cilat janë komentet tuaja?

Aeroporti, partia e kryetarit të Bashkisë kur ishte në pushtet na la një trashëgimi shumë të veçantë. Na la një marrëveshje me një kompani më të mira. Por me një klauzolë shumë problematike, sipas së cilës gjatë kohës së koncesionit të Aeroportit të Rinasit, Shqipëria nuk mund të ndërtojë në territorin e vet një aeroport të dytë. Kjo është dhurata e partisë së shokut Flamur Bime.

KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabineti "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brëndë dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve, Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / **Mob:** 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com



DASH raport për liritë fetare përfshinë dhe Shqipërinë

Departamenti Amerikan i Shtetit ka publikuar raportin e përvitshëm në lidhje me liritë fetare në botë. Në pjesën për Shqipërisë, citohe të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011. "Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, popullsia përbëhet nga 2.8 milionë banorë. Është e vështirë të vlerësohen përmasat e grupeve fetare sepse afro 20 përqind e të intervistuarve

refuzuan t'i përgjigjeshin pyetjeve opsionale të regjistrimit mbi përkatësinë fetare. Sipas regjistrimit, myslimanët sunitë përbëjnë afro 57 përqind të popullsisë, katolikët romanë 10 përqind, të krishterët ortodoksë (Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë) afro 7 përqind, dhe bektashinjtë (një formë e sufizmit shiit) 2 përqind. Grupe të tjera përfshijnë Baha'it, Dëshmitarët e Jehovait,

," thuhet në raport. DASH thotë se nuk ka pasur raportime për abuzime të lirisë së fesë. Ndërkohë problem shqetësues mbetet çështja e pronave të komuniteteve fetare. "Qeveria vazhdoi të trajtonte pretendimet nga grupet fetare lidhur me kthimin ose kompensimin e pronave të konfiskuara gjatë kohës së komunizmit; megjithatë, shumë pretendime pronësore mbetën të pazgjidhura.

Meta prezanton kandidatët për deputetë në Fier

'Bashkë me PS do fitojmë 80 mandate'

Shqiptarët s' duan lidhshirip që shikon përralla

Lajmi

Kreu i LSI prezantoi kandidatët për deputetë në Qarkun e Fierit. Ai lëshoi akuza mbi kreun e qeverisë, ndërkohë që i drejtua elektoratit se e majta e bashkuar do të marrë 80 mandate.

■■■ FIER

ARTEMISA HOXHA

Kreu i Lëvizjes Socialiste për Integrim gjatë prezantimit të kandidatëve për deputetë në Qarkun e Fierit, deklaroi se më 23 qershor Fieri, Lushnja, Mallakstra dhe të gjithë shqiptarët do t'i japin fund përrallave të doktorit në botën e çudirave sepse fieraqët dhe shqiptarë duan një lidhshirip që nuk tregon përralla, por që shikon realitetin në sy. "Prandaj më 23 qershor Fieri, Lushnja, Mallakstra dhe të gjithë shqiptarët do t'i japin fund përrallave të doktorit në botën e çudirave sepse fieraqët dhe shqiptarë duan një lidhshirip që nuk tregon përralla por që shikon realitetin në sy dhe që i jep dorën çdo të riu dhe çdo të reje, çdo të moshuari, çdo graje dhe çdo burri, për të ecur përpara dhe më shpejt në rrugën e mirëqenies, në rrugën e begatëse. Duan një lidhshirip që nuk i shmanget sfidave ekonomike por që përvesh mëngët për t'i zgjidhur ato. Duan një lidhshirip që papunësinë nuk e shikon si statistikë por si një fatkeqësi ndaj jetës dhe mirëqenies të njerëzve të thjeshtë. Duan një lidhshirip dhe një qeverisje që nuk bën listaprezenca nëpër mitingjet e saj por një lidhshirip dhe një qeveri që i jep fund ushqimeve me lista nga qytetarët në dyqanet tona", tha Meta para elektoratit fieraq. Ndër të tjera, kreu i LSI ftoj elektoratit fieraq që t'i kundërvihet presioneve për blerjen e votës. "Ju ftoj të gjithëve të ecim me shpejtësinë e rinisë së Fierit, të Lushnjës dhe Mallakstrës. Ju ftoj t'i kundërvihim të gjitha presioneve ndaj votës së lirë, sepse rezistenca e parë ndaj Sali Berishës në preken e votës është bërë nga gratë dhe nga populli i Libofshës dhe nuk ka asnjë shans dhe asnjë mundësi ai dhe kushdo tjetër që të vërë dorë mbi votën tuaj dhe mbi të ardhmen e fëmijëve tuaj", tha Meta. Ndër të tjera, Meta siguroi militantët e partisë që ai drejton se koalicioni i majtë



Ilir Meta në Fier

do të fitojë 80 mandate. "Ishte një kënaqësi e veçantë për mua që të merri pjesë në këtë takim madhështor dhe të ndaj optimizmin dhe bindjen time të plotë se Aleanca për Shqipërinë Evropiane do të fitojë 80 mandate më 23 qershor dhe një nga fitoret më të mëdha do të jetë

pikërisht në qytetin, në rrethin dhe në qarkun e Fierit", tha ai.

PREMTIMET

"LSI premtim për fermerin myzeqar dhe shqiptarë subvencionim me 50 për qind të çmimit të farërave merendiment të lartë, të pesticideve dhe plehut kimik,

subvencionim me 50 për qind të koston të instalimit të pompave dhe investimeve në sistemet e vaditjes për fermat dhe serat tuaja. Fermerët që do të angazhohen në shoqëritë bujqësore do të subvencionohen me 25 për qind të blerjes në grup të traktorëve dhe motokultiva-

Vota

T'i kundërvihim të gjitha presioneve ndaj votës së lirë, sepse rezistenca e parë ndaj Sali Berishës në preken e votës është bërë nga gratë dhe nga populli i Libofshës dhe nuk ka asnjë shans dhe asnjë mundësi ai dhe kushdo tjetër që të vërë dorë mbi votën tuaj

torëve. Ne angazhohemi për ta shndërruar Shqipërinë në një destinacion turistik ndër më tërheqësit", premtoi lideri i LSI. Sipas kreut të kësaj partie, "Kjo do të jetë në interesin e të gjithë fermerëve myzeqarë. Ne do të aplikojmë skemën e granteve, të subvencioneve të kredive agrare me interesa 3 për qind, për të rritur prodhimin bujqësor dhe për të ulur kostot e tij, për të rritur cilësinë e produkteve bujqësore dhe për t'u ulur çmimet e tyre për konsumatorët vendas, për të shtuar numrin e fermerëve dhe krijuar vende të reja pune në industrinë agropërpunuese", tha ai.

KQZ

Ndryshon fleta e votimit, PD me numrin 44

Fieri dhe Vlora me 67 subjekte, përkatohet modeli i fletës së votimit. Pritet raporti i audituesve

■■■ TIRANE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Ndryshoi dje renditjen e fletës së votimit, kjo pas një kërkesës të Partisë së Drejtave të Mohuara e Re, që renditje poshtë Partisë së Drejtave të Mohuara, çka mund të sillte konfuzion të votuesit. Kjo bëri që të ndryshonte dhe renditja e PD, ku nga nr 43 kalon në nr 44. Gjithashtu fleta e votimit në Qarkun e Fierit dhe Vlorës do të ketë përkatësinë nga 67 subjekte, ku do të jenë dhe dy kandidatët e pavaruar në fund të listës, përkatësisht Dritan Prifti dhe Arben Malaj. Mbledhjen e djeshme u miratua njëkohësisht edhe minutazhi që do të kenë partitë në RTSH, ku PS e PD do të kenë nga



60 minuta gjatë fushatës elektorale ndërsa LSI, PR, PDIU, PBDNJ do të kenë nga 30 minuta, ndërkohë që partitë e tjera që janë të regjistruara do të kenë nga 10 minuta si dhe dy kandidatët e pavaruar do të kenë të drejtën me nga 5 minuta. Debate pati edhe për ndryshimin e modelit të fletës së votimit, ku përkatësisht ndryshuan të dhënat ku numri i KZAZ, i QV si dhe bar kodi do të jenë pas fletës së votimit, e cila njëkohësisht nuk do të ketë as kundërfletë. Fletët do të prodhohen nga një firmë sllovene Cedins, e cila planifikon që fletët të vijnë në Shqipëri brenda datës 15 qershor. Sipas administratës një kuti votimi mund të mbajë deri në 600 fletë, por gjithësesi është planifikuar që KZAZ-ve tu

shpërndahen kuti rezervë. Lidhur me ndryshimin e aktit për modelin e fletës së votimit, përfaqësuesi ligjor i PS, Genc Gjonçaj u shpreh se ky akt duhet të ketë 5 vota që të konsiderohet i miratuar, gjë që u kundërshtua nga përfaqësuesi ligjor i PD, Niaz Kosovrast. Mbledhjen e sotme pritet që të miratohen dhe kërkesat e ODIHR dhe NDI, të cilat kërkojnë të akreditohen vëzhgues për zgjedhjet në 23 qershor. Gjithashtu për mbledhjen e sotme është parashikuar edhe projektvendimi për ngritjen e vendeve të numërimit të votave në Qarkun Durrës, Shkodër dhe Fier. Pritet që të shrytohet dhe raporti i dy auditëve teknikë të zgjedhur nga KQZ për auditimin e listave të zgjedhësve.

? PYETJE PERGJIGJE

■ Sa kandidatë do të ketë LSI në Qarkun e Fierit?

LSI në Qarkun e Fierit do të ketë 16 kandidatë për deputet. Meta prezantoi kandidatët duke filluar me kryesuesin e listës së LSI-së në Qarkun Fier duke nisur me Petrit Vasilin, e duke vijuar me Robert Bitrin, Ornela Zonjen, Ardian Alushin, Albert Samxnakun, Frederik Çukon, Elinor Shanin, Agim Çukan, Agim Rrasën, Bardhi Melin, Ferdinand Doksanin, Donika Canajn, me Majlinda Koçun, Semela Hoxhën, Besmir Gropën dhe Anilda Aliajn.

■ Çfarë premtimi kreu i LSI?

Meta tha se "Ne angazhohemi për një reformë industriale, angazhohemi për të realizuar në Fier dhe në Lushnjë parqe industriale, të cilat përmes lehtësive fiskale do të bëjnë të mundur tërheqjen e shumë bizneseve me qëllim krijimin e punësimit. Sepse Fieri, Lushnja, Patosi, Roskoveci, Ballshi nuk vuajnë për fuqi të kualifikuar punëtorë.

■ Kë akuzoi Meta?

Kreu i LSI akuzoi kryeministrin se po bën presione për blerje të votës, ndërkohë që garantoj se koalicioni i majtë do të fitojë 80 mandate.



**Pranimet te
Magjistratura, Halimi:
Të lehtësohen kriteret**



Ministri i Drejtësisë Eduard Halimi kërkon lehtësimin e kriterëve të kandidatëve që konkurojnë për gjyqtarë e prokurorë. Në mbledhjen e KLD-së, ministri informoi presidentin dhe anëtarët se në tryezën e tij ka mbërritur një peticion i studentëve të drejtësisë, që i konsiderojnë diskriminuese kriteret e pranimit

në Magjistraturë. "Ka arritur një peticion. Ka të bëjë me numrin e ulët të aplikantëve në shkollën e magjistraturës për shkak të vendosjes së disa kriterëve që ata i konsiderojnë diskriminuese. Disa kriteret në një shkollë të magjistraturës për të cilin unë kam bindjen se përfaqësuesit e ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuesit

e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në bord, duhet ta marrin e ta rishikojnë në mënyrë urgjente në mënyrë që ato kriteret, të cilat sipas studentëve që kanë nënshkruar peticionin duhen riparë, që kanë të bëjnë me mesataren dhe çështjet të tjera, në mënyrë që rregulloja e Magjistraturës për aplikimin e numrit të jetë sa më liberal"- tha Halimi.

Kompania, 1 milion eurot e para për numërimin elektronik

Zbardhen faturat që i kanë dhënë INDRRA-s

Rrezikohet procesi, fleta ka 66 parti jo 42

Lajmi

Janë zbardhur 4 faturat e para që firma INDRRA, që do të bëjë procesin e numërimit elektronik në Qarkun Fier, ka marrë nga buxheti i KQZ. Bëhet fjalë për shumën rreth 1 milion euro, ndërkohë që ekziston dhe mundësia e dështimit të këtij procesi.

TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Zbardhen faturat në lekë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka kaluar kompanisë INDRRA, kompania fituese e numërimit elektronik të votave në Qarkun e Fierit, njëherësh dhe të sistemit të verifikimit të zgjedhësve në Qarkun e Tiranë. Bëhet fjalë për një shumë të katër faturave që kapin shifrën rreth 1 milion euro, ndërkohë që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi që kjo kompani të ofrojë vetëm shërbimin për realizimin e Sistemit Elektronik të Numërimit të Votave në qarkun e Fierit kundrejt vlerës 1,381,075 euro pa TVSH. Pritet që KQZ t'i kalojë në llogari kësaj firme edhe pjesën tjetër të mbetur të lekëve, ndonëse deri më tani ky sistem i



Opozita

Përfaqësuesit ligjorë si dhe ekspertët për çështjet zgjedhore në PS e kanë konsideruar numërimin elektronik të dështuar. Në raportin e tyre ata kanë ngritur shqetësimin e vonesës, mosgarancisë së numërimit elektronik si marzhin e gabimit të lartë.

numërimit elektronik të votave ka paraqitur një sërë mangësish si dhe mosgarantimin 100% të

numërimit si duhej të votave. Fatura e parë kap shifrën e 15.502.842 lekëve, fatura e

dytë 7.461.962 lekë, fatura e tretë kap shifrën e 37.754.409 lekëve si dhe fatura e fundit kap shifrën e 78.356.074 lekëve. Në total këto fatura shkojnë në 139.075.287 lekë ose 993.394 euro. Pavarësisht se kjo firmë në kontratën që ka nënshkruar me KQZ, ka rënë dakord që modeli i fletës së votimit të ketë vetëm 42 subjekte nuk dihet ende se çfarë rrugë do të ndjekë KQZ me këtë proces, pasi fleta e votimit do të ketë pikërisht 66 subjekte të listuara në të, kjo pas përfundimit të verifikimit të partive dhe renditjes së tyre përfundimtare. Gjithësesi firma pati ofruar edhe një version

MUNDËSITË

- Firma të kthejë lekët nëse konsiderohet i dështuar procesi
- Të rikthehet numërimi manual nëse nuk realizohet numërimi elektronik
- Të ndryshojë modeli i fletës së votimit për Fierin nga 42 parti në 66 parti

tjetër të fletës së votimit atë me 66 subjekte, por KQZ preferoi propozimin e fletës me 42 parti. Ajo që mbetet e dyshimtë është fakti se a do t'i kthehen KQZ-së lekët e marra nga buxheti i saj, nëse do të konsiderohet i dështuar procesi. Varianti tjetër mbetet fakti që KQZ të propozoi ndryshimin e modelit të fletës së votimit, nga 42 subjekte në 66, përkatësisht aq sa kishte ofruar edhe në opinionin e dytë firma fituese e projektit pilot që do të bëjë të mundur për herë të parë në vendin tonë numërimin elektronik të votave në Qarkun e Fierit. Nuk dihet nëse ky ndryshim i fletës do të kërkojë më shumë fonde, ose çdo gjë do të jetë e përfshirë në kontratën që ka lidhur KQZ me këtë firmë.

LAJME SHKURT

Partia Socialiste: Kemi evidentuar 20 mijë dublime

Ndryshe nga numërimi elektronik në Fier, projekti i identifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve në Tiranë deri tani ka rezultuar efektiv. Ky është qëndrimi i bashkëhartuesit të Kodit Zgjedhor, Damian Gjoknuri. Ai pohon se PS po punon edhe me listat e zgjedhësve dhe në ditët e ardhshme do të bëjë publike në faqet online të saj një numër rreth 19-20 mijë zgjedhës të dyshuar si të dubtuar, që do t'ju vihen në dispozicion edhe komisionerëve. "Në kushtet e ashpërsimit të Kodit Penal, askush të mos mendojë se do të votojë dy herë", deklaroi Sekretari për Çështjet Zgjedhore në Partinë Socialiste.

KQZ, fushatë sensibilizuese për votuesit e rinj

Kryetarja e KQZ, Lefterije Luzi (Lleshi) nga shkolla e mesme "Ibrahim Hasmema", në Mullet i garantoi të rinjtë se ky institucion po bën maksimumin për garantimin e Zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe transparente. Falë projektit "Fushata e Ndërgjegjësimit të votuesve për herë të parë", të gjithë maturantët do të zhvillojnë një orë mësimi rreth të drejtës së votës, ndërsa mbi 50 përqind e tyre do të përfshihen edhe në dy orë të tjera mësimi që synojnë zbatimin praktik të njohurive të marra nëpërmjet një votimi simulues.

Gjoknuri:

Jemi përgatitur për zgjedhjet në komisionet zonale

KQZ vijon të mbetet ende pa një konensus për plotësimin me 3 anëtarët e tjerë, duke e lënë në këtë mënyrë me 4 anëtarë. Sekretari Zgjedhor në PS, Damian Gjoknuri bën të ditur se pohon se nuk ka asnjë sinjal nga Partia Demokratike për negociatë. "Nuk ka patur asnjë sinjal. E mira është që një zgjidhje të gjendet sa më shpejt. Në çdo moment Kuvendi mund të thirret dhe t'i japë zgjidhje një problemi, që për mua është një problem shumë i rëndësishëm për të pasur zgjedhje me standarde", tha Gjoknuri. Ndër të tjera, ai thotë se Partia Socialiste, sa e gatshme është për zgjidhje, po aq është edhe përgatitur për të zhvilluar zgjedhje me katër anëtarë në KQZ. Ai tregon strategjinë e PS për të menaxhuar procesin që ka me vete këtë herë dhe faktorin ndërkombëtar, nëse Kryeministri Berisha siç thotë ai, vijon t'i mbetet kokëfortësisë politike për ta kontrolluar këtë institucion. Ne do të përgatitemi për zgjedhje në çdo nivel, deri në Komisionet Zonale Zgjedhore, vende ku përfundimisht mbyllet numërimi i votave dhe del rezul-



Damian Gjoknuri

tati zgjedhor. Nëse KQZ-ja do të hyjë në proces në mënyrë të paligjshme, patjetër në mënyrë të paligjshme do të përballë me një presion të shtuar, presion popullor dhe ndërkombëtar pasi do të shkelë haptazi ligjet dhe përgjegjësia është e këtyre katër njerëzve, të cilët do të tregohen me gisht përpara publikut dhe përpara ligjit, nëse do të vendosin të hyjnë në mënyrë të paligjshme në proces", tha Gjoknuri.

#SALUS SPITALI ITALIAN MULTISPECIALISTIK

ME "SALUS" CILESIA ITALIANE NE TIRANE

Sherbimet:

- Kardiologji
- Gastrohepatologji
- Endokrinologji-Diabetologji
- Laborator Analizash
- Radiologji (CT, MRI, EKO)
- Oculistike
- Otorinolaringologji (Falas)
- Ortopedi (Falas)
- Kirurgji e përgjithshme
- Kirurgji Estetike
- Neurokirurgji
- Mjeksi Interne
- Stomatologji
- Urologji
- Pediatri
- Gjinologjia
- Check-Up

POLIAMBULATORI I RI SALUS NË QENDËR TË TIRANËS

- VIZITA FALAS !**
- Në qendër të Tiranës kemi hapur poliambulatorin e ri në rrugën Donika Kastrioti, afër dy Kullave Binjake. Këtu janë specialitetet dhe mjekët që do të gjeni dhe do ju presin:
- Gastroenterologji, Ekografi Endoskopik digjesticive - Dok. Ermira Zyjak
 - Kirurgji e përgjithshme dhe Onkologjike (Tumore) - Dok. Luca Galligaris
 - Mjekësi e Organeve të brendshme dhe Diabet - Dok. Stefano Turchetto
 - Ortopedi - Dok. Mauro Cardinale - Dok. Leonardo Basso - Dok. Mauro Di Leo

Përfitonni tani...!

Për të lënë një takim, telefononi në:
Salus Tirana Sh.a : + 355(0) 4 2390500
+ 355(0) 66 2053 180

Regjistrimi fillestar shpallet afishimi në Shkodër

Në vijim të ndërtimit të Sistemit të Ri të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (Hipoteka) njoftoi se ka filluar Afishimi Publik i Regjistrimit Fillestar të Pasurive të Paluajtshme për Zonën Kadastrale Nr. 8597, të qytetit Shkodër. Ky afishim bëhet në territorin e zonës, saktësisht në adresën Lagja "10 Korriku",

Rruga "Zogu i I", Përballë Kompleksit "URAJ", Shkodër. Periudha e Afishimit Publik do të vazhdojë 45 ditë kalendarike. Të gjitha subjektet private dhe shtetërore që kanë të drejta pronësie, ose të drejta të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme në Zonën Kadastrale Nr. 8597, janë të ftuar të verifikojnë Regjistrimin Fillestar të pasurive të tyre. Në rast se gjatë kësaj faze

konstatohen mangësi në informacionin e afishuar, atëherë pronari, si dhe personat që kanë interesa të tjera mbi pasurinë, duhet të bëjë plotësimet e nevojshme dhe t'i paraqesë vetë ato, brenda afatit të afishimit publik, në ambientin e afishimit, pranë specialistëve të ngarkuar me këtë detyrë të Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër.

Censusi, INSTAT-i jep shifrat përfundimtare

Në 10 vjet, 8% më pak shqiptarë

Lezhë e Elbasan, më shumë analfabetë

Lajmi

Ka paraqitur përfundimet e Censurit të zhvilluar dy vjet më parë Instituti i Statistikave. Sipas tyre, popullsia rezidente është pakësuar 8% dhe shtesë si qarqe ka patur vetëm në Tiranë e Durrës. Shqetësues është përhapja e analfabetizimit



Shefi i Departamentit të Reformës Ekonomike dhe Infrastruktursë pranë Delegacionit të BE në Tiranë, Francois Begeot, Drejtoresha e INSTAT Ines Nurja

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Popullsia është rritur vetëm në Tiranë e Durrës, në të gjithë qytetet e tjera banorë janë larguar në 10 vitet e fundit. INSTAT ka bërë dje publikë, në një konferencë, të dhënat përfundimtare të Censurit të Popullsisë dhe Banesave, i cili u realizua në vitin 2011. Sipas të dhënave të tij, më 1 tetor 2011 popullsia banuese (rezidente) në vend është 2.821.977 banorë, me një rënie prej 8 përqindësh nga Censusi 2001, kur kjo shifër ishte 3.069.275. Tiranë mbetet gjithnjë qarku më i madh, me 27% të popullsisë; 11% e shqiptarëve jetojnë përkatësisht në Fier dhe Elbasan; 9% në Durrës; 8% në Shkodër dhe Korçë; nga 5% në Berat, Dibër, Lezhë. Kukësi dhe Gjirokastra janë qarqet më të vogla me 3% të popullsisë në secilin qark. Në përqindjen e popullsisë sipas qarqeve 2001-2011, bie në sy rritja e numrit të banorëve në Tiranë, ku sot jetojnë gati 27% e popullsisë, nga 19,5% në vitin 2001 dhe zvogëlimi i qyteteve të tjera si Fieri e El-

basani, ndërkohë që Durrësi ka shënuar të njëjtën tendencë si Tirana. Konkretisht, Qarku Tiranë ka shënuar rritjen më të madhe (25%) dhe ai i Durrësit është zgjeruar me 7%. Gjirokastra është qarku me rënie më të madhe të popullsisë në dhjetë vjet (36%). Sipas të dhënave

të Censurit 2011, popullsia me diplomë universitare ose gradë më të lartë të fituar është në nivelet më të larta në Tiranë dhe Gjirokastrë, përkatësisht me 18.8% dhe 12.3%. Përqindja më e lartë e femrave me nivel më të lartë të arritur shkollimi është në Elbasan 55.7% e Shkodër 53.4%. Përqindja më

e lartë e meshkujve me nivel më të lartë të arritur është në Gjirokastrë 52.4% e Dibër 52.1%. Numri mesatar i viteve të shkollimit për popullsinë 15 vjeç e lartë është 10 vite, bën të ditur INSTAT. Ndërsa përqindja më e lartë e analfabetizimit është në Lezhë e Elbasan.

■ ■ ■ TIRANE

Infrastruktura FSHZh ndërton aksin Këlcyre-Sukë-Ballaban

Drejtori i Përgjithshëm i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Benet Beci, bashkë me zyrtarët e tjerë të qeverisë, inspektoi gjatë ditës së djeshme punimet për ndërtimin e rrugës Këlcyre-Sukë-Ballaban, një rrugë rurale në një zonë relativisht të vështirë dhe të kushtueshme për ndërtim, por ndërtimi i këtij aksi rrugor është i domosdoshëm, për arsye se iu shërben rreth 17 mijë banorëve të kësaj zone. Gjatë inspektimit, rezultoi se rruga



Këlcyre-Sukë-Ballaban, që është një nga rrugët kryesore, e cila lidh një zonë të izoluar prej kohësh, do të bëjë të mundur lidhjen e shpejtë me qendrat kryesore të banuara dhe rrethin nacional të rrugëve në vend për rreth 3 komuna, me 45 fshtara dhe 17 mijë banorë, që do të mund të dalin në Këlcyre përmes një rrugë të asfaltuar me gjatësi 15,24 km dhe gjërësi 5,5 m. "Këto janë zona me potencial të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit të banorëve. 45 për qind e punimeve kanë përfunduar 2-3 muajt e parë


të nisjes së punimeve. Shpresojmë që rruga të përfundojë në fillim të verës së vitit që vjen", tha drejtori i FSHZH, Beci. Projekti "Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale" është bashkëfinansuar nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë në vlerën 400 milionë USD, synon rritjen e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve, veçanërisht në zonat rurale nëpërmjet rehabilitimit të rreth 1,500 km rrugë. Aktualisht, janë financuar punimet në 107 segmente rrugore dytësore dhe lokale në të gjithë vendin, në një total prej 974 km.

SHIFRAT E CENSUSIT 2011

Përqindja e popullsisë sipas qarqeve 2001-2011



Përqindja e banorëve në raport me totalin e popullsisë në vend sipas qarqeve



Niveli i analfabetizimit në raport me totalin e popullsisë sipas qarqeve

Përqindja e popullsisë sipas qarqeve 2001-2011



Niveli i të diplomuarve me shkollë të lartë sipas qarqeve

► KURSI I KËMBIMIT VALUTOR Burimi: Banka e Shqipërisë Data 20.5.2013

\$	Dollari LEKË	109.68	NDRYSHIMI DITOR	-0.08
€	Euro LEKË	141.14	NDRYSHIMI DITOR	-0.15
£	Paund LEKË	166.68	NDRYSHIMI DITOR	-0.60
SFr	Franga LEKË	113.35	NDRYSHIMI DITOR	-0.46

► Çmimet të ushqimeve në kryeqytet Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe USAID

PERIME	Domate	83	FRUTA	Mollë	84
	Kastravec	63		Portokall	108
	Spec	153		Pjepër	215
	Lakër	53		Limon	177
	Lulelakër	180		Ullinj	172
Karrota	162	Barbunja	210		
		Patëllxhan	160		
		Kungull	70		
		Fasule	257		
		Qepë	90		
		Patate	88		

Çmimet në lekë/kg Data 20.5.2013

Mbyllet projekti i binjakëzimit të BE për standardet

Është zhvilluar në Tiranë konferenca Embyllëse e Projektit të Binjakëzimit IPA 2008 "Forcimi i Infrastrukturës Kombëtare të Metrologjisë dhe arritja e Njohjes Ndërkombëtare". Projekti me vlerë 3 milionë euro i financuar nga Bashkimi Europian ndihmon në zhvillimin dhe përfundimin e metrologjisë shqiptare me praktikatat dhe standardet më të

mira europiane. Me këtë rast, ministri i Ekonomisë Florjon Mima tha se "falë kësaj mbështetjeje, metrologjia shqiptare ka përmbytur një sërë objektivash strategjikë, duke hedhur hapa të rëndësishëm drejt njohjes ndërkombëtare dhe duke rritur sasinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për industrinë vendase". Objektiv i përgjithshëm i këtyre

investimeve ka qenë lehtësimi i integritimit të Shqipërisë në tregtinë ndërkombëtare, nëpërmjet rritjes së cilësisë së produkteve shqiptare, dhe si rrjedhojë rritjes së kapaciteteve eksportuese. Investim madhor në këtë fushë është dhe ngritja e Qendrës së Kombëtare të Metrologjisë shqiptare, e cila ka siguruar mjedise laboratorike nga më bashkëkohoret në rajon e më gjerë.

Banesat, shansi për të shpëtuar nga taksa 10%

Amnistia e tretë gjashtë muaj afat

Financat grumbulluan 33 milionë euro

Lajmi

Nga 15 maji ka nisur sërish të veprojë amnistia për banesat, që ul 10 herë taksën që duhet të paguajë personi që shtet një shtëpi, me kusht që të përfitojë nga kjo falje deri më 31 tetor 2013. Kjo është hera e tretë që ofrohet ky shans.



Një apartament që është blerë me 50.000 euro dhe në këtë moment mund të vlejë 80.000 euro, pasi ky është çmimi i orientuar nga tregu, do të shtejë menjëpërdim në masën 30.000 euro. Për këtë transakcion, taksa e sheshtë të "gjobit" me 3.000 euro. Amnistia ofron një shans përfitimi në këtë mes. Nëse aplikohet për rivlerësim të apartamentit pranë

një vlerësuesi të pasurive të paluajtshme të licencuar, pronësi i jepet vlera reale/aktuale, sipas çmimeve fiskale (në Hipotekë duke iu referuar çmimeve fiskale sipas zonave). Pra, nëse apartamenti do të rivlerësohej 80.000 euro, atëherë pronari do të paguajë në Hipotekë taksën prej vetëm 1% midis vlerës së blerjes dhe asaj të rivlerësimit dhe jo 10% (pra 1% e 30.000 eurove) e barabartë me 300 euro. Nga kjo masë përfiton edhe shteti. Nga marsi 2011, koha në të cilën nisi amnistia dhe deri në gusht 2012, ministria e Financave deklaroi se ky proces soll në buxhetin e shtetit rreth 5 miliardë lekë të ardhura, ose 33 milionë euro. Në atë kohë, qeveria deklaroi se kjo do të ishte shtyrja e fundit, por duket se në periudhë zgjedhëse është ofruar edhe një mundësi tjetër.

deri më 31 tetor të këtij viti. Ata që pritet të përfitojnë janë kryesisht emigrantët. Që në ditët e para, në fakt, filluan interesimet e qytetarëve që nuk kishin përfituar nga dy rastet e para të amnistisë. Rasti i parë daton në periudhën janar-mars 2011, më pas amnistia u shty deri në gusht 2012 dhe përsëri tani ka interes për rivlerësim.

Ku qendron leverdia nga ky akt?

Automjetet

Përgjysmohet taksa, rradhë tek Kolaudimi

Vendimi për përgjysmimin e taksave të automjeteve ka shkakuar menjëherë, ashtu sikurse pritje, edhe rradhë të gjata të pronarëve të automjeteve që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, në pritje që të paguajnë detyrime më të ulta se sa deri tani. Qytetarët kanë qenë të interesuar të bëjnë pagesën që në ditën e parë. Disa prej tyre e kishin të kaluar afatin e pagesës prej shumë kohësh, por kanë pritur të paguajnë me çmim të përgjysmuar. Shuma e paguar tani është në varësi të llojit të karburantit që përdor makina, vitit të prodhimit të saj, por për të gjithë është faturuar vetëm një e dyta e vlerës, që kanë paguar herën e fundit, duke qenë se është përgjysmuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë koeficienti, në bazë të të cilit përlogarit taksa. Ligji i ri për taksat e përgjysmuara për makinat zyrtarisht nisi të zbatohet duke filluar nga dita e djeshme, pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe



një periudhë 15-ditore. Në ligj është përcaktuar edhe formula e re e llogaritjes së taksave vjetore, afatet e pagesës për përdoruesit e mjeteve dhe penalitetet për vonesat. Detyrimet e pashlyera për vitet e shkuara, do të paguhën me gjysmë çmimi, ndërsa detyrimet që paguhën me vonesë do të jenë pa penalitete deri më 30 qershor të këtij viti. Vendosija e taksave të larta për makinat e përdorura dy vjet më parë është pritur me pakënaqësi, ndërkohë që një gjë e tillë nuk pengoi rritjen e hyrjes së makinave të tilla në vend.

KOMUNIKIM PER SHTYP

MEGATEK, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, AKAFP, GIZ dhe SwissContact organizuan nga data 30 Prill deri në 14 Maj konkurset për **Olimpiada e Aftësive Profesionale 2013**. Kjo është një iniciativë e **MEGATEK**, e cila ka për qëllim promovimin e arsimit profesional. Olimpiada përfshiu të gjitha shkollat e arsimit të mesëm profesional në Shqipëri në drejtimet Elektroteknikë, Ndërtim, Termohidraulikë, Përpunim Druri dhe Bujqësi-Kopshtari.

Olimpiada e Aftësive Profesionale ka filluar në datën 27 Mars me trajnime teorike në të gjitha fushat. Trajnimet u ofruan nga **MEGATEK** dhe furnitorët e tij. Më shumë se **15 trajnues** të huaj dhe shqiptarë i informuan nxënësit dhe mësuesit pjesëmarrës mbi zhvillimet e teknologjive të fundit në tregun botëror sipas fushave specifike.



Si pjesë e përgjegjësisë sociale të kompanisë, **MEGATEK** ka zgjedhur të fokusohet në mbështetjen e të rinjve të cilët orjentojnë drejt profesioneve të caktuara që në shkollë të mesme. Do të jenë këta të rinj të cilët nësër do të ofrojnë ekspertizë në treg me shërbimet e tyre.

Shkollat fituese në Olimpiada e Aftësive Profesionale, sipas



drejtimeve përkatëse, u shpallën:

1. Elektroteknikë: 30.04.2013 – Shkolla "Petro Sota", Fier
2. Termohidraulikë: 03.05.2013 – Shkolla Profesionale, Lushnje
3. Ndërtim: 07.05.2013 – Shkolla "Pavarësia", Vlorë
4. Përpunim Druri: 10.05.2013 – Shkolla "Karl Gega", Tiranë
5. Bujqësi (Kopshtari): 14.05.2013 -

Shkolla Profesionale Bujqësore, Trush, Shkodër

MEGATEK i dhuroi secilës shkollë fituese buxhetin prej 3.000 Euro të cilat do të përdoren për të ndërtuar një projekt të propozuar nga vetë shkolla fituese në laboratorët e saj.

Ky është viti i dytë i zhvillimit të këtyre konkurseve. Olimpiada e Aftësive Profesionale do të organizohet çdo vit nga **MEGATEK**.



AKTUALITET

Ndalohet Frroku vëllai i të dyshuarit për vrasjen e Lamajt

Ndalohet Mark Frroku, vëllai i Arben Frrokut, të dyshuarit kryesor nga policia për vrasjen e kryekomisarit Dritan Lamaj. Ai është arrestuar sapo ka dalë nga selia e Partisë Kristian Demokrate me argumentin, se në afërsi të selisë së PKD-së, kishte pasur një grindje. Selia ndodhet pranë bustit të Adem Jasharit, në rrugën e Durrësit. Por, duket se ky argument i policisë nuk...

e ka bindur Frrokun, që sapo ka dalë nga Drejtoria e Policisë, është prononcur për mediat, duke thënë, se "ky është presion policor shtetëror, orkestruar nga Ministria e Brendshme dhe ajo e Drejtësisë. U bëj thirrje larg duart nga Partia Kristiandemokrate". "Ne kishim një mbledhje të kryesisë së partis, kur më ndaluan. Historia ka nisur me arrestimin e vëllait tim; makina ime...

është ndjekur dhe më kanë kërkuar edhe celësata, sepse nuk e hapin dot, pasi është makinë e shtrenjtë. Ata kanë instaluar aty pajisjet e tyre, që unë i kam hequr, se nuk lejohet të më përgjojnë bisedat familjare", tha më tej Frroku. Vëllai i tij, Arben Frroku, edhe pse i ndaluar në Greqi dhe prët vendimin e gjykatës për ekstradim, është kandidati i PKD-së në Shkodër.

Deputeti iranian: Pranimi do ketë pasoja negative Ministrinë ping-pong për akuzat e Iranit

Tirana, asnjë reagim për muxhahedinët

Lajmi

Ministria e Jashtme dhe ajo e Brendshme, "ping-pong" me njëra-tjetrën, në lidhje me reagimin e mundshëm ndaj deklaratës së deputetit iranian, Baqer Hosseini Seyed. Ky i fundit deklaroi, se "Tirana mund të ketë pasoja nga muxhahedinët, të cilëve u ofroi strehimin politik".

GRANIT SOKOLAJ

Një ditë pas mbërritjes së 14 muxhahedinëve të parë në Shqipëri, ndërsa pritet që të mbërrijë dhe pjesa tjetër brenda muajit maj, reagimi i parë erdhi nga Irani. Një anëtar i bordit Kryesues të Parlamentit iranian, Baqer Hosseini Seyed, paralajmëroi Tiranën zyrtare në lidhje me pasojat negative, që mund të vijnë nga prezenca e anëtarëve të organizatës Mojahedin-e-Khalq (MKO). Megjithatë lajmi i deklaratave nga Irani mori dhenë, Tirana zyrtare të pati asnjë koment apo reagim ndaj deklaratave të Seyed. Të paktën, për të mbrojtur vendimin e Këshillit të Ministrave për dhënen e azilit ndaj 210 muxhahedinëve. Të pyetura në lidhje me ndonjë koment apo reagim zyrtar të mundshëm, dy ministratë shqiptare, Ministria e Jashtme dhe ajo e Brendshme, ia kanë kaluar përgjegjësinë njëra-tjetrës. Eva Kushova, zëdhënësjja e Ministrisë së Jashtme, deklaroi për Shqiptarja.com, se nuk ka asnjë reagim zyrtar për deklaratat e lëshuara nga Irani. "Ministria e Jashtme nuk ka asnjë reagim. Muxhahedinëve u është dhënë drejta e azilit në vendin tonë me vendim të Këshillit të Ministrave dhe po zbatohet nga Ministria e Brendshme. Ndaj, nëse duhet të ketë reagim, s'mund të jetë Ministria e Jashtme, e cila nuk është e përfshirë në këtë proces",

Teheran

Deputeti: Shqipëria të bëjë kujdes me muxhahedinët

Një anëtar i bordit Kryesues të Parlamentit iranian, Baqer Hosseini Seyed, paralajmëron Tiranën në lidhje me pasojat negative, që mund të vijnë nga prezenca e anëtarëve të organizatës Mojahedin-e-Khalq (MKO). Paralajmërimi vjen pak ditë, pasi në Shqipëri mbërritën 14 muxhahedinët e parë. "Qeveria e Shqipërisë duhet të shmangë përsëritjen e të njëjtit gabim që edhe vendet e tjera kanë bërë duke mikëpritur anëtarët e MKO, sepse këta njerëz janë të rrezikshme, si për sigurinë kombëtare të atij vendi, por dhe për të gjithë rajonin, ka paralajmëruar Hosseini, citon agjencia e lajmeve iriane "Fars Neës". Duke folur për agjencinë e lajmeve të Asamblesë Këshilluese Islamike, në lidhje me këtë çështje, Hosseini ngriti pyetjen: Si mundet që anëtarët të MKO-së, të cilët nuk kanë pasur mëshirë për bashkëjetuesit e tyre, të bëjnë një bashkëjetesë të paqta me qytetarë të huaj?



tha Kushova. Por, të njëjten gjë ka deklaruar edhe zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme Nardi Olli. Ai sqaroi, se "Ministria e Brendshme është vetëm zbatuese e vendimit të Qeverisë dhe nuk ka si të reagojë për këtë çështje. Nëse duhet të kishte reagim, mendoj se duhet të jetë Ministria e Jashtme", deklaroi Olli. Ndërkaq, Këshilli i Minis-

trave, deri në orët e vona të ditës së djeshme, nuk ka pasur asnjë reagim në lidhje me deklaratat e zyrtarit iranian. 14 muxhahedinët e parë mbërritën pak ditë më parë nga kampi Ashraf i Irakut, për t'u strehuar në Qendrën e Azilkerkuesve në Tiranë. Ata janë 10 meshkuj dhe 4 femra, të cilët nga qeveria shqiptare do të trajtohen si azilkerkues

Muxhahedinët

Opozita iriane kritikon zyrtarin e OKB

Sekretariati i Këshillit Kom- Sëhtar të Rezistençës Iraniane ka akuzuar dje të dërguarin e posaçëm të sekretarit të OKB në Irak, Martin Kobler, se po përpiqet të pengojë transferimin e muxhahedinëve irianë drejt Shqipërisë. Në një komunikatë të tyre, disidentët ndaj regjimit të Teheranit e akuzojnë atë se ka vonuar transferimin e 14 muxhahedinëve të popullit të Iranit nga



"Camp Liberty" i Irakut në Shqipëri. Sipas komunikatës, Departamenti amerikan i Shtetit duhet të jetë mashtruar nga raportimet e rreme të zyrtarit të OKB-së, që deklaroi se opozitarët irianë pengojnë të dërguarit ndërkom- bëtarë të hyjnë në kampet e tyre. Opozitarët kanë përgatitur një listë me 240 persona që mund të transferohen në Shqipëri e Gjermani dhe një tjetër me 100 emra

14 muxhahedinëve në Shqipëri fillimisht u bë publik në faqen zyrtare të OKB-së dhe vetëm mbërritjen e 16 majit, Ministria e Brendshme konfirmoi mbërritjen e tyre në Shqipëri. Ndërsa burime të tjera nga Ministria e Brendshme pohuan dje, se pjesa tjetër e muxhahedinëve, që ndodhen në kampin Ashraf në Irak, do të mbërrijnë brenda muajit maj. Më 16 mars, qeveria vendosi të pranohet kërkesën për strehimin në Shqipëri të 210 muxhahedinëve. Vendimi i qeverisë shqiptare është përsëritur nga shumë vende të botës, ku Departamenti Amerikan i Shtetit, ka falenderuar qeverinë shqiptare për kërkesën e dhënies së azilit të 210 personave muxhahedinë. Gjithashtu vendimi i 16 marsit është përsëritur edhe nga drejtuesit e Kombeve të Bashkuara Ban Ki Moon. Madje ky i fundit, e quajti vendimin e qeverisë shqiptare, si një veprim që duhet të merret shembull edhe nga vendet e tjera të OKB-së.

Maqedoni



Kapen 150 kg hashash, në pranga shqiptarë

Mbi 150 kilogramë drogë të llojit marjuanë janë sekuestruar të djelën në mbërrimje në një aksion të policisë së Maqedonisë, në rajonin e Strugës dhe Ohrit. Mësohet, se në pranga janë vënë disa persona dhe sipas policisë maqedonase, mes të arrestuarve ka edhe shtetas nga Shqipëria. Ministria e Punëve të Brendshme informoi, se bëhet fjalë për një operacion të gjërë kundër rrjetit të trafikimit të lëndëve narkotike. Sipas kësaj ministrie, sot pritet të jepen detaje të tjera mbi operacionin dhe anëtarët e rrjetit të trafikimit të drogës.



Qendra Kombëtare e azilkerkuesve



**Athinë, arrestohet
tiranasi duke vjedhur
Viagra në farmaci**

Një shqiptar nga Tirana është arrestuar orët e para të ditës së djeshme, pasi ka shpërthyer një farmaci në një zonë të Athinës, Halandri. Shqiptari nuk e ka kuptuar që ka aktivizuar sistemin e fshehtë të alarmit dhe në këtë mënyrë është lajmëruar policia, e cila ka mbërritur në vendngjarje pas pak minutash. Shtetasi shqiptar i moshës 47-vjeçare, me inicialet L.M., është arrestuar

menjëherë pa rezistencë. Nga kontrolli që iu bë, i janë gjetur plot 16 kuti me Viagra, të cilat i kishte grabitur nga farmacia. Shtetasi shqiptar, i cili është pranonar i një kafeneje tradicionale në Agia Paraskevi të Athinës, pyetjes së policëve, se përse vodhi vetëm Viagra, i është përgjigjur me sineritet çarmatosës, duke thënë, se donte t'ua tregonte pleqve dhe pensionistëve,

të cilët ishin klientë të kafenesë së tij dhe që nuk kryenin dot fiziologjikisht aktin e dashurisë, thuhet në portalin e internetit news.gr. Ndërsa sot, shqiptar me inicialet L.M. do të çohet përpara prokurorit, i cili do të ngrërë akuzën ndaj tij. 47-vjeçari, sipas policisë, mund ta ketë bërë edhe herë të tjera një veprim të tillë, për "t'ju shërbyer pensionistëve".

Ndue Pjetri vë kushte. I pandehuri: Paguajeni

200 mijë euro për mbrojtjen e Dajtit

Avokati kryesisht "çmend" Krimet e Rënda

Lajmi

Një avokat ka pranuar të mbrojë Dritan Dajtin, të akuzuar për vrasjen e 4 oficerëve të policisë në Durrës, pak vite më parë. Por, Ndue Pjetri, i njohur në proceset penale, ka vënë kushte. Ai i ka kërkuar gjykatës 200 mijë euro dhe një muaj kohë të përgatitet, pasi të njihet me dosjen. Megjithë kërkesën e Dajtit, gjykata nuk e ka pranuar.

TIRANE

GRANIT SOKOLAJ

Gjykata e Krimeve të Rënda në Tiranë, ku po gjykohet Dritan Dajti, kur kishte humbur shpresat te avokatët që e kishin emrin në listën kryesisht, ka caktuar një tjetër avokat, po kryesisht, por emri i tij nuk ishte në listën e dhënë nga Dhoma e Avokatëve. Ndue Pjetri është paraqitur dje në sallën e gjyqit, pikërisht në seancën e 220-ë gjyqësore, duke bërë që të mendohet, se u gjet një avokat për të mbrojtur Dritan Dajtin. Por, sapo avokati ka nisur të flaës, trupi gjyqësor dhe prokurori i çeshtjes kanë mbetur të habitur. Ndue Pjetri, i cili duket se ishte thirrur për të mbrojtur Dajtin, pa u konsultuar më parë, ka vënë dy kushte: "Për të mbrojtur Dritan Dajtin, unë kërkoj 30 ditë kohë që të njihem me dosjen dhe të përgatitem për mbrojtjen, si dhe 200 mijë euro pagesë", ka thënë Pjetri. Para trupit gjyqësor në seancën e djeshme gjyqësore, në Gjykatën e Krimeve të Rënda, Ndue Pjetri, i

PYETJE PERGJIGJE

Pse u çudit gjykata nga kërkesa e avokatit?

Ndue Pjetri ishte caktuar kryesisht nga Krimet e Rënda për të mbrojtur Dritan Dajtin, duke menduar se mund ta bënte kundrejt pagesave zyrtare, 5 mijë lekë për seancë. Por, përderisa Pjetri nuk është në listën e avokatëve kryesisht, i ka lindur e drejta të vërë kushte për pagesën dhe afatet.

Çfarë ndodhi me seancën ndaj Dritan Dajtit?

Dje ishte seance e 220-ë ndaj të akuzuarit për vrasjen e katër oficerëve të policisë, të gjitha të shtyra. Shkak për këtë janë bërë avokatët, të cilët e kanë shpërthyer procesin, duke munguar pafundësisht dhe pa asnjë arsye. Madje, edhe ata që ka zgjedhur vetë klienti Dajti.

A parashikohen masa disiplinore ndaj avokatëve?

Komisioni i Disiplinës, i Dhomës Kombëtare të Avokatëve, prej disa javësh ka nisur të verifikojnë dosjet e avokatëve që shtynë procesin "Dajti". Ndaj një avokati u mor masa e pezullimit të licencës për 6 muaj, ndërkohë që Dhoma ka të drejtën edhe t'jua heqë përjetësisht licencat avokatëve.



Avokati Ndue Pjetri

caktuar nga shteti si avokat për të mbrojtur Dajtin deklaroi se ishte gati të mbronnte të pandehurin e akuzuar për vrasjen e 4 policëve, në seancat e ardhshme gjyqësore, por me kusht që të paguhet 200 mijë euro për punën tij. Dhe, sipas tij, nëse gjykata bie dakord, atëherë kërkon dhe 30 ditë kohë për të përgatitur mbrojtjen.

Në këto moment, gjykata ka vendosur të ndërrë jashtë gazetarët dhe kamerat e televizioneve. Por, në këtë moment, i pandehuri Dajti i ka kërkuar trupit gjyqësor që ta pranojë kërkesën e avokatit. "I kërkoj gjykatës të pranojë

kërkesën e avokatit. Më pëlqen performanca e tij. Oferta 200 mijë euro është më e ulëta nga të gjitha, duhet të pranohet", tha Dajti. Për Prokurorin e çeshtjes Ardian Nezha, është një tjetër tentativë për të shtyrë procesin. "Avokati është palë me të pandehurin dhe kërkojnë të zvarrisin gjyqin", theksoi Nezha. Në përfundim, trupi gjyqësor i drejtuar nga Idriz Milkurti, vendosi të mos pranojë kërkesat e avokatit Ndue Pjetri dhe të shtyjë seancën për nesër (sot), duke caktuar kryesisht avokaten Violeta Veshi dhe avokat Zini Qinamin. Procesioni i avokatit është



Dritan Dajti

privat dhe ushtruesit e shohin atë si biznes. Në këto kushte, avokatët mund të vënë çfarëdo çmimesh në kërkim të mbrojtjes së një të akuzuari dhe nuk i pengon ligji. Por, duke llogaritur pagesat nga shteti, që marrin avokatët e caktuar kryesisht, kërkesa për 200 mijë euro, duket paksa e ekzagjeruar. Megjithatë, Pjetri, megjithëse ishte caktuar nga gjykata për të mbrojtur Dajtin, nuk e ka emrin në listën e avokatëve kryesisht, të cilët, Dhoma e Avokatëve ia dërgon gjykatës. Një avokat kryesisht, paguhet nga shteti maksimumi 5 mijë lekë për seancë e në zbritje, në varësi të proceseve gjyqësore.

Dritan Dajti akuzohet se me 7 gushtit 2009 ekzekutoi efektivët e policisë, Saimir Duckollari, Altin Dizdari, Fatos Xhani dhe Kastriot Feskaj, pjesë e skuadrës speciale operacionale të cilët tentuan ta arrestonin të shumë-kërkuarin.

Elbasan




Vidhen për skrap 3.5 kilometër shina treni

Shumë kilometra shina të vjedhura në qarkun e Elbasanit. Siç mësohet nga burimet institucionale, ato janë vjedhur nga disa persona të ndryshëm, me qëllim tregëtimit e tyre për skrap. Nga verifikimet e vëra në terren, janë vjedhur shinat e linjës hekurudhore që lidh qytetin e Elbasanit me Fabrikën e Çimentos, me gjatësi 3.5 kilometër. Vetëm në katër muaj, në këtë segment janë vjedhur për skrap nga persona të papërgjegjshëm, afro 2 kilometër shinë hekurudhore. Ndër vite, kjo linjë hekurudhore është përdorur për transportin e mallrave dhe të punonjësve të fabrikës por, sot ky segment është katandisur në gjendje të mjeruar. Drejtori i Mirëmbajtjes së Hekurudhës në Elbasan, Petrit Tola, është shprehur se, "situata paraqitet problematike në shumë zona të hekurudhës ku, drejtoria e Elbasanit duhet të mbulojë një sipërfaqe shumë të madhe me hekurudhë nga Rrogrozina deri në Pogradec".

GREQI 1 mln euro

Dy të arratisurit grabitën bankën

Klement Gala dhe Admir Murataj janë dy shqiptarë të arratisur nga burgu i Trikalas dhe që dyshohet se kanë grabitur mbi 1 milionë euro në bankën e Larisë, të enjen e javës së kaluar. Shuma e madhe e eurove të grabitura nga Banka Kombëtare greke në Larisa të Greqisë u bë publike dje nga mediat greke. Dy shqiptarët janë pjesë e grupit prej 11 vetësh, të cilët në muajin mars u arratisën nga burgu i Trikalas, në një operacion të mirëorganizuar.



Që prej ditës së arratisjes, 11 shqiptarët akuzohen dhe për grabitjen e një supermarketi,

ndërsa Ermal Lita, një tjetër shqiptar i arratisur nga burgu, akuzohet se është përfshirë në vdekjen e 25-vjeçares Katerina Zogaj, e cila u vra aksidentalisht gjatë shkëmbimit të zjarrit me policisë greke dhe të arratisurve. Sipas gazetës greke "Ekathimerini", grabitësit e bankës së Larisë janë Klement Gala dhe Admir Murataj, 42 vjeç. Grabitja ishte kryer pa maska por punonjësit e bankës ishin terrorizuar me pistoletë dhe kallashnikov.

MerrJep.al

Blije atë që të duhet!
Shite atë që nuk të duhet!

Tregu më i madh në Shqipëri për shit-blerje

Për më shumë informacion na vizitoni në faqen tonë të website: www.MerrJep.al

KËRKOJ APARATE FOTOGRAFIK METALIK TË VJETËR

Tiranë, kërkoj të blej Aparate Fotografik Metalik të vjetër. Koleksionoj aparate fotografike të vjetër të të gjitha markave. **TEL+35596688888**

IPHONE 5 FACTORY UNLOCK

Iphone 5 factory unlock i ardhur nga Italia shumë pak i përdorur as një muaj 16 gb i bardhë. **TEL. 0692401666**

PEUGEOT 206 BENZINË 1.1CC,

Shes Peugeot 206 motor 1.1cc benzinë me dokumenta të rregullta targa italiane. Makina ka 120.000 km, origjinale me 4 dyer, tapiceri super e pastër me goma të reja të sapo vëna me faturë HANKOOK, disqe alumini, kasetofon mp3. **TEL. 0686803203**



Alban Kotorri



Altin Poda



Anton Kola



Bekim Lika



Besnik Lieshi



Besnik Zekthi



Bledar Hanelli



Bledar Sulaj



Blerim Kokici



Brunild Ramaj



Emiljano Beqiri



Endri Gjymshana



Enver Jaho



Ezmir Boja



Genci Alia

Superorganizata

SHQIPTARJA.COM zbulon pamjet ekskluzive të pjestarëve të rrjetit të heroinës, kokainës dhe trafikut të femrave në disa prej vendeve të Bashkimit Evropian

Zbulohen fotot e 31 anëtarëve të bandës

Grupi i drogës u shkatërrua më 10 prill

Lajmi

Zbulohen fotot e supërbandës shqiptare të trafikut të drogës e prostitucionit, e shkatërruar në muajin prill 2013. Bëhet fjalë për grupin prej 34 personash, të arrestuar mëngjesin në 10 prillit, nga një operacion i koordinuar, që të zhvillohej në të njëjtën orë në Shqipëri, Itali, Belgjikë, Holandë e disa vende të BE-së.

TIRANE
GRANIT SOKOLAJ

Pas më shumë se një muaji, gazeta "Shqiptarja.com" zbulon pamjet 31 prej 34 anëtarëve të organizës kriminale, që sipas hetimeve të prokurorisë dhe policisë, kanë investuar më shumë se 20 milionë euro në Shqipëri. Bëhet fjalë për të arrestuarit e operacionit ndërkombëtar të koduar "Sotto Tracia", numri i të cilëve është 31, mes tyre edhe një femër. Hotele, lokale, karburante, të ndërtuara me lekë trafikesh, gjendeshin në zonën e Elbasanit, Librazhdit e deri në kufi me Maqedoninë. Dhe, kur mendonin se ata ishin harruar, në derë iu ka tokitur policia. Bëhet fjalë për të shqiptarë të arrestuar përgjatë orëve të mëngjesit në qarkun e Elbasanit dhe Tiranës. Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda, njoftuan më 10 prill, se në pranë kanë rënë Sokol Tafani, Festim Hoxha, Rezart Tirana, Higer Allko, Brunild Ramaj, Altin Poda dhe Bledar Shabani. "Departamenti Kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, finalizoi me sukses operacionin ndërkombëtar të koduar 'Sotto tracia - AL', për hetimin dhe goditjen e një organizate kriminale, që merrej kryesisht me 'Trafikimin në sasi të mëdha të lëndëve narkotike të llojit Kokainë dhe Heroinë', 'Favorizimi dhe shfrytëzimi të prostitucionit', 'Favorizimi dhe qëndrimi i të huajve klandestin në vendet e BE-së'. Kështu deklaruan në një konferencë për shtyp Edmond Rizai, Drejtor i Drejtorisë së Luftës Kundër Krimin



Edmond Rizai, Drejtor i Drejtorisë së Luftës Kundër Krimin të Organizuar dhe Eugen Beci Drejtues i Prokurorisë së Krimeve të Rënda

të Organizuar dhe Eugen Beci, Drejtues i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, gjatë një konference të përbashkët për shtyp, më 10 prill. Veprimet për finalizimin e Operacionit Ndërkombëtar "Sotto Tracia", janë koordinuar nga EuroJust, i cili ka realizuar bashkëpunimin e koordinimin e veprimeve njëkohësisht edhe në 6 shtete të tjera, Shqipëri, Itali, Belgjikë, Francë, Holandë dhe Zvicër, ndërsa numri total i të arrestuarve është 34 vetë, nga të cilët, 10 në Itali, nga një në Belgjikë, Francë e Holandë dhe 3 në Zvicër.



Festim Hoxha

"Nga të dhënat dhe hetimet e kryera, të arrestuarit nuk kanë asnjë precedent në Shqipëri. Në lidhje me drogën, ata e trafikonin nga Holanda, Franca e Belgjika drejt Italisë. Ndërsa për çështjen e shfrytëzimit të prostitucionit, grupi shfrytëzonte vajza nga vendet e Lindjes dhe nuk rezultoi asnjë rast me vajza nga Shqipëri", theksuan Beci e Rizai. Ndërkaq nga burime të tjera kofidenciale, mësohet drejtuesit e grupit të trafikut në vendet e BE-së, janë tre nga arrestuarit e gjithë grupit të trafikut dhe konkretisht, Festim Hoxha, Oliver Hoxha, i prangosur në Itali dhe Rezart Tirana, nipi i tyre. Ndërkaq dje, Shqiptarja.com ka zbuluar fotografitë e të arrestuarve në vende të ndryshme të BE dhe në Elbasan.



Lorence Shebegu



Marjan Poda



Matilda Boja



Gevi Ibrahim



Giovanni Rigante



Jani Hysa



Klajdi Hoxha



Leonard Jupa



Leonard Qoshi



Mirjan Ismaili



Olsi Kucja



Renat Tafani



Rezart Jaho



Sokol Tafani



Tigert Allko

DIGITALB

**TOKESORE
KANALI 48**

*Do na ndiqni në
gjithë Shqipërinë*

DIGITALB

**SATELITOR
KANALI 50**

*Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë,
Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi
dhe në pjesën tjetër të Europës*

VALË UHF

**NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER**

ABC
ALBANIAN BROADBAND COMMUNICATION

KANALI 158

A1 REPORT!

Origjina e Lajmit



GJITHMONE PRANE JUSH!

www.shqiptarja.com



Koment

Fushata si armike e së majtës



NGA **PREÇ ZOGAJ**

vijon nga faqja 1

...estradë, estradë e dhimbshme, por duke parë se disa prej aktorëve e kishin marrë seriozisht këtë plagjiaturë, nuk mund të mos ndjeje keqardhjen e thellë dhe neverinë që shkakton imitimi në provincë i zakoneve metropolitane. Imitimi në provincë i zakoneve metropolitane konsiderohet në fakt kulmi i provincializimit. Imagjinoni tani se sa e papërtypshme është, për çdo lloj stomaku që ka parë pak botë me sy imitimi i paradave të vjeve në konventën e një partie politike shqiptare. Vëzhguesit të sipërcituar, që mbështet pa zemër rotacionin, ndoshta do t'i kishte mjaftuar kjo për të thënë frazën e tij të hidhur. Mirëpo hyneret majtiste paskeshin qenë në seri atë të dielë pasdite. Doli fjala se një politikan tashmë i vjetër, duke dashur të pikurojë larminë e kryeqytetit shqiptar, e paskësh krahasuar Tiranën me Jeruzalemin! Sa e rëndësishme është kultura për ata që kujtojnë se dinë! Dhe fill pas kësaj thagme, të recuperueshme gjithsesi, pasi injoranca ka kosto minimale në politikën tonë, ja ku mbërriti nga Skrapari deklarata patjetër e porositur e Nasip Naços se Ilir Meta do të jetë kryeministrit i së majtës së bashkuar pas 23 qershorit. Nëse kjo e majtë fiton zgjedhjet. Kjo ishte kryethagma që duhet t'u ketë rënë si bombë Edi Ramës dhe mbështetësve të tij. Ende pa filluar fushata zyrtarisht, e majta e bashkuar lajmëron me zërin e LSI-së se do të startojë dhe shkojë drejt ditës së zgjedhjeve si këmbët e dhisë. Kjo do të thotë se halvës që Rama dhe Meta kanë pjekur prej një viti dhe marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe që u nënshkruan me salltanet para pak ditësh u mungon një pikë thelbesore. Pika se kush është kryeministri hije, kush do të jetë kryeministrit i ardhshëm në rast fitoreje të së majtës. Nuk dihet a e kanë trajtuar këtë çështje Rama dhe Meta në takimet e tyre, ndoshta nuk e kanë zënë fare në gojë dhe gjasat janë të mos e kënë zënë fare në gojë, përndryshe nuk do të konkuronin të dy si kryeministra hije. Vetë shmangia e çështjes flet shumë për të çarët dhe pikpyetjet e pakit që kanë bërë. Publiku, gjith-

sesi, nuk do të kishte kuptuar gjë po të mos " i fliste shpirti" Nasip Naços.

Në pamje të parë duket se kjo deklaratë është bërë për të shtuar votat për LSI-në, duke shkuar me mendimin se njerëzit votojnë me shumë ata që konkurojnë për të qenë në krye se sa ata që konkurojnë për të qenë pas tyre. Sidoqoftë, pasojat e një deklaratë të tillë në rrafshin e marrëdhënieve brenda së majtës janë të mëdha. Ka ndodhur që një koalicion partish të indikojë njëzëri për kryeministër një aleat pa shumë peshë elektorale, siç ka qenë rasti i Romano Prodit në Itali. Por në mungesë të një marrëveshjeje të tillë nuk kemi dëgjuar që aleatët më të vegjël të partisë së madhe të kënë pretendime për postin e kryeministrit. Pretendime të tilla gërryjnë parimet e respektit mbi të cilin ngrihet një koalicion partish dhe janë në kundërshtim me ligjin apo zakonet që indikojnë kurdoherë si kryeministër hije kryetarin e partisë



Edi Rama

më të madhe të opozitës. A është LSI partia më e madhe e së majtës në Shqipëri? Jo. A ka shanse LSI të bëhet partia më e madhe e së majtës në Shqipëri përgjatë tridhjetë ditëve

të fushatës? Jo. Sondazhet e çdo lloji e tregojnë atë rreth tetë herë më të vogël se PS, një diferencë që nuk mund të mbyllet kurrë në harkun e një fushate elektorale. Mekanizmi

i vetëm i Metës për të shërbyer ambicie si këto që artikulojnë zëdhënësit dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë është pakica bllokuese. Në këtë kontekst, "Meta kryeministër"

tradhëton në një plan më të gjerë mendimin " Rama, jo kryeministër". Ditë të vështira për kryetarin e PS-së. Dhe nuk mund të ndodhë ndryshe për një politikan që heq dorë nga moraliteti si arma më e vyer e opozitës në betejat e saj. Rama nuk do të mund të pretendojë nga aleati i tij i ri atë që ka mohuar për t'u bashkuar me të. Do s'do, ai do të jetë deri në fund lodra dhe vegla e tij.

Pretendimi kryeministër i Metës pritet ta trazojë edhe më kuadrin tashmë të trazuar të së majtës. Deri dje, duke parë tërheqjen e Ramës pas 1 prillit nga shumë blloqe te programit elektorale, kemi thënë e argumentuar se armiku i tij më i madh janë tridhjetë ditët e fushatës. Tridhjetë ditë janë shumë për të mos thënë asgjë. Por të dielën u pa se ka më keq, se me fjalë e hartime edhe shtyhet deri në fushatë, ndërsa budallalëqet, provokimet dhe hilerat brenda llojit justifikojnë shprehjen sarkastike që cituam në krye të këtij shkrimi.

[SHQIPTARJA.com]

NE VERSIONIN DIXHITAL

KURSENI!


Lexojeni gazetën në
iphone ipad

DUKE BLERË ABONIMIN, JU MUND TË LEXONI GAZETËN QË NGA ORA 2:00 E MËNGJESIT, DHE PAGUANI MË PAK

në kompjuter

Në adresën: www.shqiptarja.com

SHKARKON FALAS APP TE SHQIPTARJA.COM NGA APPLE STORE





HISTORIA

Tekste dhe tituj të rinj për vitin akademik 2013-2014

Në tregun e librit shkollor janë futur tituj të rinj tekstesh. Këtë gjë e konfirmon edhe këshilltari i ministrit të Arsimit, Jovan Kristiqi. Ai thotë se për vitin e ri shkollor janë përfshirë 16 tituj të rinj për metodat e përmirësimit të gjuhës angleze. "Shtim titujsh ka edhe për librat e minoritetit, duke plotësuar kështu nevojat. Teksteve për shkollat profesionale i janë shtuar 15 tituj"

shpreh Kristiqi për ATSH. Sips tij, çmimi i teksteve shkollorë të arsimit parauniversitar ka ndryshuar vetëm duke përfshirë normën e inflacionit në vend. Çmimi i teksteve nuk ka ndryshuar me përjashtim të një rritjeje 1.7%, sa ka qenë inflacioni i raportuar nga Instituti i Statistikave. Tashmë shkollat në të gjithë vendin kanë përfunduar përzgjedhjen e teksteve dhe ato do të

dërgohen pranë shtëpive botuese. Të gjitha tekstet do të jenë gati në vitin e ardhshëm shkollor, ndërkohë që janë përfunduar nga përzgjedhja tekstet e vjetra. Këtë vit risi në tekstet alternative kanë qenë ato të gjuhëve të huaja. Si zakonisht librat shkollorë do të fillojnë të shpërndahen në fund të muajit gusht. Përsa i përket skemës së subvencionimit ajo nuk do të ndryshojë.

Një vit pas tragjedisë së Himarës, tregon detajet e aksidentit

Besjana: Parandjeva se do rrëzoheshim

"Armandi më mbuloi në krahët e tij"

Lajmi

Besjana tregon se si e mori vesh humbjen e të fejuarit Armandit "Lajmin tragjik që më ndryshoi jetën e mora vesh nga familja e të fejuarit, pas dhjetë ditësh, ndërkohë që më ishte thënë që ai po kurohej në spital dhe ishte jashtë rreziqut për jetën. Mbas aksidentit, lajmi për humbjen e Armandit ishte goditja fatale për mua".

KAVAJE

JONIDA ALIU

Kisha një parandjenjë se do rrëzoheshim. Këtë ja thashë edhe të fejuarit tim Armandit" nis rrëfimin e saj për "Shqiptarja.com" e mbijetuar e tragjedisë së Himarës Besjana Xheneti, një vit pas aksidentit. Ajo më tej tregon "Mbah mend që pas ndalesës në Apolloni, ku bëmë dhe fotot e fundit, autobuzi vijoi rrugëtimin drejt Sarandës. Po e shikoja që diçka nuk po shkonte mirë dhe se shoferi kishte probleme në manovrimin e mjetit. Pastaj vendosa të flija pak dhe të mos mendoja për këto gjëra negative sepse ndihesha shumë e lodhur nga rruga. Ishin pikërisht ulërimat e vazjavave dhe të shoferit të autobuzit ato që më zgjuan nga gjumi. Hapa sytë dhe vërejtja se poshtë ishte një humnerë mjaft e thellë. Ngriva dhe u tmerrova e tëra. Mbah mend që autobusi doli nga rruga dhe e kuptova se ishte në ajër. Më pas e gjeta veten të mbuluar në gjak, kisha dhimbje në trup dhe pamundësi për të lëvizur. Gjatë gjithë kohës thërrija të fejuarin tim Armandin, ndërkohë që përreth dëgjoja zërat e himarjotëve, të cilët na erdhën në ndihmë dhe për ata shpreh një falenderim të madh" tregon Besjana Xheneti, një prej vajzave të mbijetuar nga aksidenti i Himarës, që ndodhi një vit më parë. Me lot në sy ajo na tregon edhe për momentin që i fejuari i saj Armandi e ka shtërnguar në krahët e tij dhe i ka premtuar se asaj nuk do i ndodhte asgjë e keqe, dhe se ai do ta mbronte. Gjithashtu ajo rëfen edhe sesi e mori vesh lajmin e tmerrshëm të humbjes së fejuarit "Lajmin tragjik që më ndryshoi jetën e mora vesh nga familja e Armandit, pas dhjetë ditësh, ndërkohë që më ishte



Besjana Xheneti, e mbijetuar e tragjedisë së Himarës

Himarë

Si ndodhi tragjedia e studentëve në ekspeditë

Në 21 maj të 2012-ës një aksident tragjik ndodhi pranë qafës së Vishës, në Himarë, ku një autobus me 33 studentë të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", dega Gjuhë-Letërsi, ka dalë nga rruga dhe ka përfunduar në një greminë rreth 80 metra të thellë. Në aksident humbën jetën 13 persona dhe 22 studente u plagosën. Mes viktimave ishte edhe shoferi i autobusit 55-vjeçar, Pëllumb Çela. Sipas ekspertizës shkak të këtij aksidenti ishte shpejtësia e madhe e autobusit. Viktimat e aksidentit ishin Denisa Guzi nga Gramshi, Ermira Mana nga Elbasani, Aurora Molla nga Pogradeci, Lindita Kabashi nga Elbasani, Joana Debinja nga Lushnja, Elsa Daka nga Elbasani, Juliana Tola nga Elbasani, Armand Halilaga nga Kavaja, Fabiola Shehi nga Bërçalla Tiranë, Eriola Xhoi nga Elbasani, Eranda Baloshi nga Elbasani, Dorina Stafa nga Kruja.

thënë që ai po kurohej në spital dhe ishte jashtë rreziqut për jetën. Mbas aksidentit, lajmi për humbjen e Armandit ishte goditja fatale për mua. Në ato momente hoqa aparaturat që kisha në trup dhe u largova me familjen e tij në Kavajë. Mund të them vetëm që dhimbjet etrupit nuk kishin të krahasuar me dhimbjen e shpirtit". Ndonëse jeta

vazhdoi me lot e dhimbje në shpirt askush nuk mund të fshijë nga kujtimet atë aksident tragjik. Sot u mbush plot një vit nga tragjedia e Himarës dhe Besjana tregon se ai aksident ka lënë gjurmë të thella dhe dhimbje të pashërueshme në jetën e saj "Jeta ime nuk është më si më parë, ka ndryshuar çdo gjë. Kam akoma plagë dhe

shumë dhimbje në trup, para dy muajsh bëra operacion këmbën. Dhimbjet e forta të kokës më shoqërojnë çdo ditë, dhe vazhdoj të marr akoma ilaçe. Pjesën më të madhe të kohës e kaloj në varreza, ndoshta kështu ndihem më pranë dashurisë time Armandit. Familja e të fejuarit më qëndron pranë dhe vazhdoj të kem kontakte shumë të mira me ato". Mbas marrjes së diplomës rinisa studimet për master në degën e "Gjuhë letërsi". U shkëputa nga shoqëria që kam pasur në tre vjeçare pasi vetëm unë vazhdoja me partitimesepse kishat të vështirë të jetoja në atë qytet ku kisha shumë kujtime si me shoqet që nuk jetojnë më ashtu edhe me Armandin. Me vajzat e tjera që ishin të prekura nga tragjedia takohem shpesh dhe kujtojmë momentet e aksidentit". Por kur e pyesim Besjanën se a e informuar është ajo në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim që shoqet e saj i kanë drejtuar shoqërisë "Sigma" ajo shpreh se nuk është përfshirë në këto protesta, por ka informacione se dëmshpërblimi që ata pretendojnë të japin është tepër qesharak dhe i papërfillshëm nisur nga lloji i aksidentit që ishte me pasojë të rënda për secilin prej tyre. Besjana thotë se "Data 21 Maj e vitit 2012 ishte ditë e zezë që tronditi të gjithë

PYETJE PERGJIGJE

Përse protestuan vajzat e mbijetuar nga aksidenti i tragjedisë së Himarës?

Vajzat e mbijetuar nga aksidenti i tragjedisë së Himarës, protestuan para një muaji për arsye se kompania e sigurimeve nuk i dëmshpërbleu. Kjo në bazë të sigurimit që kishte bërë autobuzi

Cili është pretendimi i vajzave?

Sipas tyre kopania SIGMA, nuk u ka dhënë shumë që atyre u takonte. Por ai ishte një dëshpërbim qesharak, që atyre nuk u plotëson asnjë nga shpenzimet që ato kishin pasur për t'u kuruar.

Cili është pretendimi i kompanisë?

Sipas kompanisë së sigurimeve SIGMA, vajzat do marrin shpërblimin që u takon, kjo sipas dëmit që kanë pësuar. Sipas drejtuesve të kompanisë SIGMA, vajzat nuk kanë plotësuar dokumentacionin e duhur.

Çfarë detyrimi i lind kompanisë së sigurimeve?

Në bazë të kontratës (sigurimit TPL), autobusi ishte i siguruar pranë kompanisë SIGMA. Duke qenë se ky lloj sigurimi mbulon palët e treta, studentëve që ishin pasagjerë të autobusit, u ka lindur menjëherë e drejta e dëmshpërblimit.

popullin shqiptar dhe ndryshoi rrjedhën e jetës të secilit prej nesh. Ajo që përjetuam ishte një merr me sy hapur, një makt që do më shoqërojë gjatë gjithë jetës. Gjatë një vite plagët e trupit mund të shërohen por plagët e shpirtit do të dhembin gjithmonë" përfundon ajo.

LAJME SHKURT

■ **Ulet interesi i nxënësve për degën e ndërtimit**
Firmat e industrisë së ndërtimit në vendin tonë përgjithësisht punësojnë punëtorë jo të kualifikuar, me paga minimale, duke ngushtuar mundësinë e punësimit të të rinjve të diplomuar në fushën e ndërtimit, gjykon drejtori i shkollës "Karl Gega", Agim Jakupi. Kjo shkollë profesionale, që përgatit teknikë dhe punëtorë të aftë në ndërtim, mobilieri, konfeksione, hidrosanitarë etj, evidenton se nxënësit po tregojnë interes për profilet që lidhen me mekanikën. Sipas drejtorit Jakupi, shkaku kryesor i pakësimit të nxënësve në fushën e ndërtimit, edhe pse kjo industri kryesore në tregun e punës, është se firmat private punësojnë njerëz me paga minimale dhe të pashkolluar në këtë profil. Përballë këtij realiteti të rinjtë zgjedhin profile të tjera.

■ **DSHP -ja në Fier merr masa për sezonin veror**
Drejtoria e Shëndetit Publik në Fier është angazhuar maksimalisht për standarde higjienike në të gjitha plazhet e qarkut. Sipas nënëdrejtoreshës së kësaj drejtorie, Shpëtime Kalemaj, që prej disa javësh inspektorët e DSHP kanë ndërmarrë një sërë takimesh me njësitë vendore dhe përfaqësuesit e biznesit, që ushtrojnë aktivitetin në vijën bregdetare. Ata kanë lënë një sërë detyrimesh të gjitha subjektet dhe njësitë vendore, me qëllim detyrimin e tyre për të respektuar standartet higjieno-sanitare dhe krijimin e kushteve sa më të mira për pushuesit. "Drejtoria e Shëndetit Publik ka angazhuar të gjithë punonjësit e inspektoriatit, ka lënë detyra dhe tani jemi në fazën e rikontrrollit, apo verifikimit të zbatimit të tyre", tha ajo

■ **Rruga Vlorë-Sarandë bllokohet për disa orë**
Rruga nacionale që lidh Vlorën me bregun dhe Sarandën në afërsi të vendit të quajtur "Kalaja", u bllokua dhe si pasojë e rreshqitjes së një mastivi gurësh në asfalt dhe në det. Për disa orë rruga ka mbetur e bllokuar. Si pasojë e bllokimit të këtij aksi shkaktuar nga gurët e rëzuar, autoritetet u detyruan të qëndrojnë në radhë në të dy anët e rrugës. Ndërsa menjëherë pas rreshqitjes së dheut në vendin e ngjarjes ka mbërritur edhe policia.



Vlorë, rritet interesi i të huajve për të birësuar fëmijë shqiptarë

Ciftet e huaj po kërkojnë gjithnjë e më shumë të birësojnë fëmijët shqiptarë, kështu shprehet Olta Ganaj, drejtoresha e shtëpisë së fëmijëve jetimë në Vlorë. “Interesi i çifteve të huaj për të birësuar fëmijë shpatarë është gjithmonë e në rritje” tha Ganaj. Në shtëpinë e foshnjës në Vlorë strehohen fëmijët e braktisur dhe qëndrojnë aty deri në moshën 6 vjeçare,

më pas ata largohen për në Shtëpinë e Fëmijës në Sarandë ose në Vlorë. Vitet e fundit është shënuar një kurbë në rritje e fëmijëve të cilët braktisen e lihen jetimë. Por ka edhe nga ato familje të cilat për shkak të kushteve të këqija ekonomike dhe si pasojë e divorceve dorëzojnë fëmijët e tyre nën kujdestarinë e edukatoreve dhe personelit të shtëpisë së fëmijës. Aktualisht

në këtë shtëpi qëndrojnë rreth 30 fëmijë të braktisur të moshës nga zero deri në 6 vjeç. Shtëpia e fëmijës në Vlorë është një nga më të vjetrat në Shqipëri. Nga kjo shtëpi janë rritur dhe edukuar me qindra jetimë të cilët sot janë edhe në poste të veçanta pune, por ka edhe nga ata të cilët fati i keq i jetës së tyre i ka qëndruar i tillë gjata gjithë kohës.

Shkolla ku mësojnë fëmijët e braktisur rrezikon të mbyllet

Fshati SOS jep alarmin për ndihmë

Shkak për mbylljen e saj është bërë mungesa e fondeve

Lajmi

Shkolla e Fshatit SOS, rrezikon të mbyllet. Shkak për mbylljen e shkollës së këtij fshati është mungesa e fondeve. Sipas burimeve konfidenciale, drejtuesit e këtij fshati janë në bisedime me strukturat shtetërore për të mos e mbyllur shkollën. Fshati SOS-së, është një ndër institucionet që u vjen në ndihmë fëmijëve të braktisur.



Shkolla në fshatin SOS

Arsyeja

Sipas Burimeve konfidenciale nga Fshati SOS, shkak për mbylljen e shkollës është bërë mungesa e fondeve. Fshati SOS është një organizatë jofitimprurëse që u vjen në ndihmë fëmijëve të braktisur ose që rrezikojnë të braktisen nga prindërit.

ndihmë të fëmijëve që kanë humbur kujdesin prindëror apo që janë në rrezik për të humbur atë. Fshati SOS ndodhet në periferi të Tiranës, në një mjedis të gjelbër, ngjitur me selinë e Presidentit. Brenda kompleksit ka qerndhe, kopësht, shkollë 9 vjeçare, mjedise ushqimi, fjetjeje, sportive, argëtimi, kursesh për të rinj, etj. Pra funksionon si një kompleks shumëplandësh, siç duhet të jetë një qendër jetimore moderne, por e mbështetur gjithnjë nga donacionet private të huaja dhe shqiptare. Fshati SOS-së është ndërtuar rreth 17 vjet më parë nga SOS Kinderdorf International, krijuar nga Herman Gmeiner në vitin 1949 dhe me shtrirje në 132 vende të botës. Fshati SOS është një nga hapësira e vetme humane, evropiane dhe dinjitoze të trajtimit të fëmijëve jetimë në Shqipëri. Fshati i SOS ofron kujdes për fëmijët që e kanë



humbur kujdesin e familjeve të tyre. Fshati SOS është i vetmi institucion që kujdeset për të rinjtë e braktisur nga mosha 14-18 vjeç, të cilët nuk kanë kujdes prindëror. Në këtë fshat shumë fëmijë dhe adoleshentë të braktisur, ose që rrezikojnë të braktisen nga prindërit e tyre, strehohen dhe edukohen.

■ ■ ■ TIRANE
JONIDA LATE

në përbërje e tij. Shpresojmë që bisedimet në të cilat ne jemi, për të mbajtur shkollë në jetë, të rezultojnë pozitive dhe jetëgjatësia e shkollës dhe zgjasë të sa më shumë”. Ndonëse ende nuk është asgjë zyrtare, alarmi për mbylljen

e tij është dhënë. “Nuk është ende zyrtare që shkolla do të mbyllet, por deri sa nuk ka asgjë zyrtare në momentalisht jemi në kushtet që shkolla rrezikon të mbyllet” thonë burime nga Fshati SOS. Ky fshat është një organizatë sociale, jo fitimprurëse, jopolitike dhe jofetare që vepron në

KORÇE Thirrja

Jetimët protestojnë në ditën e tyre

“Jemi në gjendje të vështirë, do i heqim fëmijët nga shkolla, na detyrojnë kushtet kur i nxjerrim të lypin”

■ ■ ■ KORÇE

Në ndihmoni!, Jemi në mes të rrugëve dhe të papunë!, me këto thirrje jetimët e rajonit të Korçës, kanë protestuar ditën Ditën Ndërkombëtare kushtuar kësaj kategori, duke kërkuar ndër të tjera, përmblidhjen dhe respektimin e të drejtave që ju takojnë me ligj. Përballë kushteve të vështira, me të cilat përballen çdo ditë kjo kategori, ka apeluar për ndihmë, ndërsa ka akuzuar se asnjë prej institucioneve nuk ju është përgjigjur në këto 20 vjet nevojave të tyre, në strehim, punësim dhe arsimim. “Jemi në gjendje të vështirë, do i heqim fëmijët nga shkolla, na detyrojnë kushtet edhe kur i nxjerrim të lypin. Ne marrim rreth 5 mijë lekë në muaj, çfarë të



Protesta e jetimëve në qytetin e Korçës

bëjmë me kaq lekë? Është turp, punë nuk ka, por janë dhe racistë. Na shohin nga ngjyra e lëkurës. I lutemi shtetit, të verë dorë për të gjithë jetimët, pasi jemi në rrugë të madhe”, shprehet, Lili Shirgu një gjyshe që rrit dy fëmijë vetme. Nuk kam asnjë ndihmë. Jam e papunë dhe jetoj me qira”, shprehet, Ida Taci nga Maliqi. Protesta e jetimëve para shtëpisë së foshnjës, “Lulet e Vogla”, ku gjithashtu rriten fëmijë të braktisur, është organizuar nga shoqata e jetimëve në Korçë, nga drejtuesit e së cilës është pohuar gjendja e vështirë. Sipas sekretares së shoqatës, Boralda Merollari vetëm në rajonin e Korçës numërohen 4900 jetimë, 2900 prej tyre janë të papunë dhe pa strehim. Një problematikë tjetër është dhe mungesa e një zyre, ku

kjo kategori mund të drejtohet, ndërkohë që prej më shumë se një viti takimet kryen në lulishte dhe lokale. “Në qarkun e Korçës numërohen rreth 4900 jetimë, ku 2900 prej tyre janë të papunë dhe pa strehim. Ndërkohë nuk ka dhe një zyrë ku kjo kategori të drejtohet për probleme. Prej një viti i kryejmë takimet në terren, lulishte ose lokale. I bëjmë apel shtetit ta ndihmojë këtë kategori, jo të kujtohen vetëm për votë” u shpreh Boralda Merollari. Gjendjen e mjeruar të jetimëve e ka pohuar në këtë ditë edhe nënkryetari i bashkisë, Sotiraj Filo, i cili premtom mbështetje. Në Ditën Ndërkombëtare kushtuar Jetimëve, në qytetin e Korçës Bashkia ka ndarë dhuratat për fëmijët e shtëpisë së foshnjës, “Lulet e Vogla”. **da.is**

Mesiti: Arsim dhe strehim për jetimët pas moshës 16 vjeç

Në Ditën Kombëtare të Jetimëve Kozeta Mesiti, drejtuese e Shërbimit Social Shtetëror premtoi se do të ofrohet ndihmë edhe për jetimët mbi moshën 16 vjeç. Sipas Mesitit është menduar që shumë shpejt të ngrihet një qendër sociale kalimtare për jetimët nga moshja 16- 25 vjeç, të cilëve do tu ofrohet ndihmë në arsim, strehim e punësim. Aktualisht statusi i jetimit i siguron

këto të drejta deri në moshën 16 vjeç. "Ne po mendojmë që të krijojmë një qendër rezidenciale kalimtare, nga moshja 16-25 vjeç. Ne duam që në këtë qendër të ofrohen dhe shërbime, mundësi kualifikimi dhe ata të dalin me një formim të caktuar në jetë. Projekti është bërë dhe presim një financim nga donatorë të ndryshëm dhe qeveria shqiptare", tha Mesiti. Sipas drejtueses së

Shërbimit Social Shtetëror numri i birësimëve është rritur, por janë shtuar kriteret për familjet që kërkojnë të birësojnë fëmijë. "Janë 66 kërkesa për kujdestari, jo të gjitha mund ta fitojnë sepse ne bëjmë një kujdes shumë të madh për respektimin, plotësimin e kriterëve, të cilat duhet të përmbushen sipas akteve ligjore", shprehet Mesiti.



Aktiviteti te pedonalja "Murat Toptani" për Ditën e Jetimë

Historia e 9-vjeçarit jetim, Flavio Xhani

Gjyshi: Për nipin do kujdesem deri në vdekje

Nëna i vdiq dy vjet më parë, babai e braktisi

TIRANE
JONIDA LATE

Nëna e e tij ka vdekur para dy viteve, ndërsa babai e ka braktisur atë që kur ai ishte 5 vjeç. Flavio Xhani tani është 9-vjeç dhe jeton me gjyshërit e tij në Kavajë. Në 20 maj, Ditën Kombëtare të Jetimëve, ai bashkë me gjyshin e tij kishin ardhur në Tiranë, për të marrë pjesë në aktivitetet që u organizuan për këtë ditë. Kur ai ishte 7 vjeç nëna e tij vdiq nga kanceri i gjirit, dhe që atëherë për të janë kujdesur gjyshërit. "Flavio është djali i vajzës time. Flavio atëherë ishte 7 vjeç, kur ime bijë ndërroi jetë. Vajza më vdiq nga kanceri i gjirit në 27 gusht të 2011 dhe që atëherë për Flavion kujdesemi unë dhe gruaja ime. Babai e ka braktisur atë që kur ai ishte 5 vjeç. Nuk e di se ku jeton, por thonë që ka vdekur në Greqi" tregon Qemal Xhani, gjyshi i Flavios. Qemali tregon se kur e bija e tij ishte sëmure ajo i kishte kërkuar që ata të kujdeseshin dhe ta mbanin Flavion, ashtu siç ishin kujdesur për të. "Vajza jetonte këtu në Tiranë, por ku u sëmur më tha unë po iki, po dua të vdes në vendin tim dhe e morëm në Kavajë. Ndërsa për Flavion më tha që dua të më kujdesesh shumë ashtu siç u kujdesë për mua". Ndërsa dashuria e nënës së tij i mungon prej 2-vitesh, kurse e babait prej 4 vjetësh Flavio tregon se nëna dhe gjyshi kujdesen shumë. "Që kur isha i vogël para se nëna ime të vdiste unë shkoja shpesh te gjyshi dhe gjyshja. Ndërsa tani jetoj me ta, ata kujdesen shumë për mua dhe më duan shumë"-tregon Falvio, i cili dje, ashtu si të gjithë fëmijët e tjerë, mbante të veshur një bluzë të bardhë ku në të shkruhej "Dua dashuri jetëgjatë, jo vetëm për fushatë". Ndihma ekonomike që marrin të



NË FOTO: (majtas) Flavio Xhani, jetim (djathtas) Gjyshi i Flavios, Qemal Xhani



moshuarit për t'u kujdesur për nipin e tyre 9-vjeçar nuk është e madhe, por nuk i ka penguar gjyshit të plotësojë dëshirat e një fëmijë 9-vjeç. "Marrim një ndihmë vetëm 8 mijë lekë në muaj dhe asgjë tjetër. Vështirësitë janë të shumta. Ne na ka ndihmuar edhe shumë kryetari i Bashkisë së Kavajës, Elvis Roshi. Ai e ka mbështetur shumë Flavion dhe ne" tregon Qemali, gjy-

"Vajza jetonte këtu në Tiranë, por ku u sëmur më tha unë po iki, po dua të vdes në vendin tim dhe e morëm në Kavajë. Ndërsa për Flavion më tha që dua të më kujdesesh shumë ashtu siç u kujdesë për mua"

shi i 9-vjeçarit. "Flavio është një fëmijë shumë i mbarë, deri tani është shumë i mirë edhe me mësimë ka dalë me 10-ta në shkollë" thotë Qemal Xhani. Flavio është një fëmijë shumë i zgjuar, në shkollë ai ka marrë edhe fletëlavdërim për rezultatet e larta në mësimë, ndërsa lënda që atij i pëlqen më shumë është matematika. "I kam qejf të gjitha lëndët, por ajo që më pëlqen më shumë është

STATISTIKA

- Institucionet e Përkujdesit Shoqëror Publike dhe Jopublike, për fëmijët jetim
- **Institucione publike**
- 9 institucione rezidenciale me 256 fëmijë nga të cilët 190 fëmijë janë jetime social dhe 66 jetime biologjik
- 3 institucione publike ditore me 70 fëmijë
- **Institucione jopublike**
- 15 institucione jopublike rezidenciale me 332 fëmijë prej tyre
- 18 fëmije jetim biologjik dhe
- 314 jetime social
- 38 shërbime komunitare ditore me 1609 fëmije jetim dhe me probleme sociale

Fëmijët

Çumani: Humanizmi i shqiptarëve për jetimët mungon

Fëmijët jetimë nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, të veshur me bluza dhe kapele të bardha, u mbledhën dje në një marshim në rrugën pedonale "Murat Toptani", ku është vendosur dhe një ekspozitë fotografike mbi 97 vjetorin e strehës së parë vorfnore. Aktivitetet sensibilizuese, për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me mungesë prindërore, u organizuan nga Instituti Kombëtar i Integritimit të Jetimëve Shqiptarë me mbështetjen e Zonjës së parë, Odeta Nishani.

Shkodra, Berati, Elbasani, Pogradeci, Saranda, Kavaja, etj. Ilir Çumani Drejtor i Institutit Kombëtar të Integritimit të Jetimëve Shqiptarë u shpreh se "Problematikat e tyre janë të gjithanshme, dhe të një game të gjerë. Një prej tyre është dhe mungesa e humanizmit të shoqërisë. Humanizmi do ta bënte shoqërinë tonë më të drejtë dhe më aktive duke i lehtësuar plagët sociale këtyre fëmijëve", shprehet Çumani. Drejtuesi i Instituti Kombëtar të Integritimit të Jetimëve Shqiptarë tha se sloganin "Dua dashuri jetëgjatë", para qytetarëve dhe të pranishmëve në këtë aktivitet, parakaluan rreth 200 fëmijë nga institucione dhe qendra rezidenciale të ndryshme në mbarë vendin. Fëmijët e moshave nga 6 deri më 14 vjeç kishin ardhur së bashku me kujdestarë e tyre nga qytete si,



tuti Kombëtar të Integritimit të Jetimëve Shqiptarë tha se sloganin "Dua dashuri jetëgjatë", jo vetëm për fushatë", e kanë zgjedhur vetë fëmijët. "Ky slogan është një apel që fëmijët e sjellin në këtë ditë të veçantë, për politikanët që në një farë mënyre janë dhe shkaku kryesor i dramës së këtyre fëmijëve" thotë Çumani.

matematika" tregon 9-vjeçari nga Kavaja. Qemali i përlotur sa herë që flet për nipin e tij thotë se "Unë jam gjyshi i Flavios, por nuk paska gjë më të keqe se jetim në jetë. Unë dua të përgëzoj ata që për ditën e

jetimëve kanë bërë gjithë këtë organizim dhe bëjnë diçka edhe për këta" tregon Qemali. Flavio ashtu si dhe fëmijët e tjerë, që kanë statusin e jetimit duan vetëm një gjë: që mos të braktisen edhe nga shteti.



Profil

■ ■ ■ TIRANE

VLADIMIR F. MOLLA

Më 20 maj të vitit 1928 lindi Andromaqi Gjergji. Dje ajo mbushi 85 vjet. Jubile që ia vien të përmendet po të kemi parasysh jetën dhe punën e kësaj gruaje jo të zakonit, e cila vazhdon të punojë pa ndërprerë për t'i lënë popullit si trashëgim një vepër të madhe, por për t'i bërë shqiptarët të ndërgjegjshëm dhe krenarë për kulturën e tyre - sidomos atë materiale - që ata kanë pasur. Kjo kulturë me kalimin e viteve është shndërruar në thesar dhe si e tillë duhet ruajtur me kujdesin më të madh, jo të shkatërrohet e shpërdorohet, siç po ndodh kohët e fundit.

Andromaqi ka lindur në Korçë. Nuk është e tepërt të përmendet ndikimi magjik që ka pasur ky qytet në formimin e shumë personaliteteve, ndërmjet të cilëve Andromaqi ze një vend të veçantë. Jo vetëm nga shkollimi i ulët dhe i mesëm që kreu në këtë qytet, por nga lidhjet e pandërprera dhe të shumëllojshme që ka krijuar me të. Njohja e thellë që ka përfutur prej një pune shumë të gjatë dhe frutdhënëse e vlerave, që mbart qyteti me fushën dhe malësinë e tij është pasqyruar më së miri në vepërën e saj.

Indro Montaneli në librin e tij "Shqipëria një e një mijë". (1) qytetit të Korçës i ka bërë si asnjë tjetër një vlerësim të veçantë dhe shumë domethënës, të pangjashëm me asnjë qytet tjetër të Shqipërisë, që ai kishte vizituar. Jemi të detyruar ta përmendim këtë jo vetëm se ai flet shumë mirë për këtë qytet, por se është e vetmja dëshmi historike e shkruar, e lënë prej një vëshguesi të huaj dhe që duhet mbajtur mirë ndër mend, aq më tepër që në ndonjë përkthim, nga po citojmë më poshtë nuk është dhënë e saktë: "E çuditshme! Qyteti më lindor i Shqipërisë është në të njëjtën kohë, më perëndimori.... Njëzet e pesë mijë banorët e Korçës janë njëzet e pesë mijë borgjezë dhe e kanë bërë qytetin e tyre një Milano të vogël të Shqipërisë jugore. Rrugët e tij të pastra, shtëpitë e tyre të sakta dëshmojnë për një rend qytetar (civil); prodhimet me dorë të qilimave dhe fabrika e madhe e tij e prodhimet të birrës dëshmojnë për një rend ekonomik. Fushat përqark, të pastruara me zell, të piktuara me dashuri dëshmojnë ndërhyrjen dhe veprimin e popullit mbi tokën e tij. Në se më në fund do të thahet kënetata e Maliqit, ajo do të bëhet një hangar i madh gruri, një pllajë me një këlim të ëmbël që do të thotë se është i krijuar nga njerëz prej brumi shumë të mirë" (2)

Andromaqi është shprehur për qytetin e Korçës: "Unë i detyrohem shumë qytetit tim të lindjes, sepse me gjithë vështirësitë e periudhës që kalonte pas Luftës së Dytë Botërore, vazhdohe të ishte një ndër qytetet e para me tipare europiane: me rrugë të shtruara, me shkolla ku jepnin mësim mësuës të kualifikuar, qyteti ku kishte librari plot me libra, revista, tekste shkollore, shqip e në gjuhë të huaj, dy shtypshkronja, bibliotekën, dy

PËRMES ekspeditave të shumta brenda dhe jashtë vendit ajo ka qëmtuar në skutat më të largëta të tij shejza nga më të ndryshmet, që i kanë shërbyer për të studiuar në terren veshjet tona kombëtare, për të mbërritur në përfundime shkencore të një niveli mjaft të lartë....



Shqiptarkë nga të Athinës

Andromaqi GJERGJI

Portreti i panjohur i akademikes së parë shqiptare

Ajo festoi dje 85-vjetorin, ndërsa në jetën e saj u shënuan vepra të mëdha në mbrotje të trashëgimisë tonë



Vepra

Vepra e saj nuk ka qenë rrjedhojë vetëm e një studimi të gjatë dhe të pashembullt të pargjeve të librave të autorëve të vendit dhe të huaj mbi kulturën materiale të popullit, mënyrës së tij të jetesës etj, por mbi të gjitha e njohjes në imtësi të trualit shqiptar, jetës të njerëzve që në mijëvjeçarë janë ngulur në këto troje.

NË FOTO: Andromaqi në moshë të re

kinema, parqe, lulishte me një pazar nga më të bukurit në Ballkan". Andromaqi është e bija e Llambi

Jorgjit, i cili ka ardhur në Korçë prej SHBA në një kohë shumë kritike për fatet e vendit, në vitin 1920. Ai nuk


u kthye më nga kishte ardhur, por bleu këtu shtëpi dhe krijoi familje. Në të njëjtën kohë u angazhua me përkushtim në krijimin dhe veprimin e institucioneve të Shtetit shqiptar, të cilat morën formë pas viteve 1920, sidomos mbas shpalljes së Mbretërisë më 1 shtator të vitit 1928, kur Andromaqi kishte disa muaj që kishte lindur. Nga detyrat e rëndësishme që ka kryer Llambi, ka qenë ajo e sekretarit të Prefekturës të Korçës. Me një kujdes të admirueshëm ka pasqyruar të shkruar në ditar çdo veprim të kryer në detyrën e ngarkuar, deri edhe orët e ditës së punës të tij, që në shumicën e rasteve i kalonin ato të caktuara me ligj. Mbresa të pashlyeshme të le gjendja e tij emocionale e krijuar mbas përfundimit të një pune të gjatë dhe të lodhshme që ka pasur të bëjë me krijimin për herë parë të arkivit të Prefekturës, që përveç sistemit e klasifikimit të dokumentave të gjetura ka përfshirë dhe dokumenta e krijuara rishitaz. Nuk mund të mos të të prekë shënimi: "Sot jam shumë i kënaqur mbasi përfundova krijimin e arkivit". Në arkivin e krijuar prej Llambi Jorgjit ka pasur edhe dokumenta me shumë vlerë, si ato të lëna nga dora e Th. Gërmenjtit etj. Llambi ka qenë aq i kujdesshëm, sa ka shënuar

në ditar edhe martesën e parë civile të një qytetari, mbas hyrjes në fuqi të Kodit të parë Civil të shqiptarëve më 1 prill të vitit 1929. Llambi është ati edhe i dy djemve, Kristaqit dhe Ilo Jorgjit. Të dy me prijje të thella në fushën e arkivave. Kristaqi është njëri prej filatelistëve e numizmatëve më të mirë të Shqipërisë. Arkivi i tij përmban edhe dokumenta me vlerë, sidomos për shoqërinë "VATRA", anëtar i së cilës ka qenë dhe ati i tij. Pasioni i Ilo Jorgjit për të dokumentuar zhvillimin e sporteve në qarkun e Korçës është i njohur. Nga gjithë këto del, se Andromaqi nuk është një dukuri e rastit, por rrjedhojë e ndikimit të qytetit mbi të si dhe e kultivimit familjar.

Të shkruash për veprën e një akademiku, sidomos kur kjo vepër është shume e gjërë, si në volum, ashtu edhe në cilësi, duhet të jesh në mos akademik, të paktën i fushës. Kështu e kërkojnë parimet e njohura të rrënjosura në shekuj. E thënë me gojë e popullit duhet të jesh i një sërë, me atë për të cilën po shkruan. Por kur guxon dhe lapsin e merr jo si i zanatit, se fjalët të dalin nga zemra, mirë është që askush të mos të të qortojë.

Kur flasim për akademizmin duhet ta kuptojmë atë, në më të shumtën e shkalla më e lartë e idealizmit, atd-hedashurisë, përkushtimit, dijës dhe profesionalizmit. Andromaqi u pranua në Akademinë e Shkencave të Republikës të Shqipërisë në mars 1999, mbasi kishte marrë më parë gradën e doktorit të shkencave historike (1980) dhe atë të profesorit më 1994. Sipas kujtimit të një të afërmit të Andromaqit i pranishëm në këtë ngjarje të rëndësishme, kryetari i Akademisë, Z. Ylli Popa, me rastin e pranimit të Andromaqit si anëtare të Akademisë, ndër vlerësimet e shumta që kishte bërë pati thënë: "Franca, femër e parë, Jursenar-in 3 e pranoi në akademi pas 300 vjetëve të krijimit të saj, ndërsa ne Andromaqin, pas 30 vjetëve".

Për të mos u zgjatur me këtë per-





Andromaqi Gjergji

OBJEKT i studimeve të saj ka qenë edhe jeta në diasporat shqiptare, si arbëreshët e Italisë dhe ata të Greqisë. Me qëllime studimi ka shkelur në atë kohë edhe hapësira të ish Jugosllavisë, të banuara prej shqiptarëve

VLERËSIMI

Ylli Popa: Në Francë akademikja e parë pas 300 vjetësh, ne Andromaqin, pas 30 vjetëve

prej vrundullave të shumta historike që kanë kaluar shqiptarët, sepse siç ka bërë të ditur një shkencëtar tjetër i madh (në mos gabohem, Çabej), që në kohët e vjetra ilirët dhe më pas edhe shqiptarët, kanë qenë në mënyrë të vazhdueshme në një proces rruhdje dhe ngushtimi (restriksioni), asnjëherë faktorë dhe pjesëmarrës të një zgjerimi (ekspansioni). Në rrethana të tilla, duke u zbythur vazhdimisht, ata kanë sjellë me vete në trojet e sotme edhe kulturën që mbartnin prej vendeve nga vinin. Nga ana tjetër, kur aautorja është e bindur dhe e sigurt, nuk nguron t'i japë përfundimet të sigurta, duke i mbështetur në prova bindëse. Kështu, ndërmyjet gjetjeve arkeologjike të pasqyruara në figurat 162 (burrrë me fustanellë, gur i gjetur në Maribor, Slloveni - shek. V p.e.r.) dhe 163 (burrrë me fustanellë, faqe 174 - 175 të librit "Veshjet Shqiptare në Shekuj", botim i vitit 1988 ka përcaktuar, se fustani ka qenë një pjesë e hershme veshjeje e përdorur nga fiset e ndryshme ilire, që ngjan me veshjet e keltëve, prej nga e trashëguan skocezët. Po kështu

NË FOTO: Dr.Sali Zavalani, fotografi e vitit 1929



të pashoq. Dukuritë që shfaq jeta e shqiptarëve, ajo nuk i kufizon vetëm në rrafshin etnografik, por i shtrir edhe në marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç janë ato të pronësisë. Studuesja Gjergji e ndjek hap pas hapi çifligun dhe, nëpërmjet tij, marrëdhënien juridike të pronësisë mbi tokën, lëvizjen e ndërrimit e zotërimit të saj nëpërmjet marrëdhënieve kontratore, që janë rritur mbas fillimit të shthyrjes së lëtij shtetit të çifligut. Është mjaft interesante përmendja e shembujve në këtë drejtim. Andromaqi ka vërtetuar që kontrata të tilla janë lidhur edhe me personalitete të rëndësishme, siç është rasti i Mustafa Pashë Gjiritit, (9), që ka shitur në fshatin Rrëmbectoka, prona të tij. Këto ishin vetëm disa prej vlerave që dalin nga vepra e madhe e Andromaqi Gjergji. Duke i uruar asaj jetë të gjatë dhe shëndet të mirë dëshiroj ta mbyll këtë shkrim me fjalët e Edi Shkruarit në librin "Gra të Shquara të Shqipërisë": "Andromaqi është një vlerë kulminante e shkencës shqiptare dhe ndër më të shquarat në etnologjinë europiane dhe botërore".

sonalitet të shquar, Margaritën dëshiroj të them - siç themi në për këdo emrin të parin -, se prej saj në bibliotekë kam në originalin librin: "Letra miqve të saj e të tjerëve". (4) Kur lexon në titull "miqve të saj", në vend të "miqve të mi" kupton që libri nuk është botim i akademikës në fjalë. E gjithë lënda që përmban libri është e Margaritës, por përmbledhja e saj me shënime e shpiegime të hollësishme është punim original i Mishelë Sard-it (Michele Sard) e Jozef Brami (Joseph Brami), të cilët në bashkëpunim me Eljana Dezon Xhons (Elyane Dezon -Jones) i kanë kushtuar këtë libër prej 720 faqesh botuar prej "Galimard" më 1995 jo Margarita Jursenar-it, por kujtimet të arkivistit të parë të saj, Grace Frick, prej punës së palodhur të cilët është themeluar e gjithë lënda e librit. Ky arkivist ka lënë kopjet prej karboni të origjinalëve të një pjese të mirë të letrave që ruhen në Bibliotekën Houghton të Universitetit të Harvard-it. Pra, ka qenë vëmendja dhe kujdesi i dikujt tjetër, e arkivistit të saj, që bëri të mundur shpëtimin dhe ruajtjen e kësaj pjese të veprës të Margaritës. Kushtimi që i bëjnë këtyj autorët e librit është plotësisht i përligjur.

Ndërsa "Margarita" jonë ka qenë vetë autore dhe vetë arkiviste. Cilësitë e saj si arkiviste e shkëlqyer u dukën jo vetëm në grumbullimin dhe ruajtjen e dokumentacionit ku ka mbështetur veprën e saj, por edhe të një sërë objekteve që kanë bërë koleksione të vyer, dëshmi e pa kundërshtueshme e jetës materiale të shqiptarëve vendosur në një rrjet muzeuesh të kulturës

popullore të krijuara para viteve 1990, por që fatkeqësisht mbas këtyre viteve u shkatëruan dhe, ashtu si njerëzit, morën rrugët e Botës. Vepra e saj nuk ka qenë rrjedhojë vetëm e një studimi të gjatë dhe të pashembullt të pingjeve të librave të autorëve të vendit dhe të huaj mbi kulturën materiale të popullit, mënyrës së tij të jetesës etj, por mbi të gjitha e njohjes në imtësi të truallit shqiptar, jetës të njerëzve që në mijëvjeçarë janë ngulur në këto troje. Me një durim të pasosur, nëpërmjet ekspeditave të shumta brenda dhe jashtë vendit ka gëmtuar në skutat më të largëta të tij shejza nga më të ndryshmet, që i kanë shërbyer për të studiuar në teren veshjet tona kombëtare, për të mbrurit në përfundime shkencore të një niveli mjaft të lartë. Objekt i studimeve të saj ka qenë edhe jeta në diasporat shqiptare, si arbëreshët e Italisë dhe ata të Greqisë. Me qëllime studimi ka shkelur në atë kohë edhe hapësira të ish Jugosllavisë, të banuara prej shqiptarëve. Nuk është niutuar në dhënien e përfundimeve, aq më pak të shprehura në mënyrë të prerë për çështje të rëndësishme. Fjalët "mund të jetë kështu", apo edhe nënteksti i tyre janë të pranishme në shumë faqe të veprës së saj.

Për librin "Veshjet Shqiptare Në Shekuj" i është dashur të studiojë lloje të panumërta veshjesh, modele, motive, ngjyra e stile të ndryshme. Materialet me të cilat janë bërë këto veshje, vendet nga kanë ardhur etj kanë qenë objekt i veçantë i studiues. Numri i madh i veshjeve, që ndeshen sot në vendin tonë shpiegohet edhe



Malësore Dukagjini

Hulumtimi

Për librin "Veshjet Shqiptare Në Shekuj" i është dashur të studiojë lloje të panumërta veshjesh, modele, motive, ngjyra e stile të ndryshme. Materialet me të cilat janë bërë këto veshje, vendet nga kanë ardhur etj kanë qenë objekt i veçantë i studiues

kishte ndaluar vënieën prej nuseve të monedhave të floririt ndër festet. Ndalime të tilla i bërë edhe prej komuniteteve të tjera, si ai katolik i Shkodrës, i cili me anë sullesh vendosi në vitin 1840 të kufizonte shpenzimet e tepërta. Këto ndalime u përsëritën edhe më vonë, derisa në vitin 1910 i shpallti ato (sullet) në formë të shkurtuar. (7) Në Korçë, në vitet 1920 u ndalua që dasmat të mos zgjasnin si më parë, një javë, por vetëm dy ditë.

Nuk i kanë shpëtuar vëmendjes së Andromaqi Gjergji as formulat e përshëndetjes, pjesë e etikës qytetare të kohës, që kanë qenë të ndryshme midis besimeve të ndryshme.

Andromaqi në librin tjetër të saj (8) ka hyrë thellë në jetën e popullit, të cilën përpigjet ta zbërthejë me kujdes

1Indro Montanelli, ALBANIA UNA E MILLE, G.B. PARAVIA & C., dalë nga shtypi më 30 shtet 1939. Autori ka qenë një prej gazetarëve më të shquar dhe jetëgjatë në Itali. Ka jetuar deri pas viteve 1990.

2Indro Montanelli, ..., faqe 49-50.
3Yurcenar (Margaritë) de Crayencour, e quajtur Margaritë, gruaja e letrave, me shtetësi franceze dhe amerikane (lindur në Bruksel më 1903 dhe vdekur më 1978 në Mount Desert, Maine, SHBA. Mori famë prej veprës së saj "Kujtimet e Hadrianit" (1952), ka botuar romanet (puna në të zezë, 1968), "Orientalet e saj të reja" (1938), esetë (nën fitimet e inventarit, 1978), kujtimet familjare (kujtimet e besimtarit 1973) të zotëruara prej mitëve të Antikitetit etj. Ka qenë gruaja e parë anëtare e Akademisë franceze zgjedhur më 1980 (Larousse 1997).

4Letres a ses amis et quelques autres.
5Tegellë me fije ari të përdorur për qëndisjen e pajës nga ana e nuses dhe gajtanë të qëndisur po me fije ari për të stolisur kostumet të shtresës së pasur.

6Materialet dokumentare për Shqipëri-në Juglindore të sh. XVIII- Fillimi i sh. XX, botim i A. Shkencave të RPSSH 1981.

7"Leka" nr. 4, prill 1937, faqe 170.

8"Mënyra e jetesës në sh.XVIII-XX" botim i vitit 2002.

9Guvernatori i Kretës (Gjiritit), i njohur për rreptësinë e tij, por edhe në të njëjtën kohë për ndershmërinë e drejtësinë që mbante. Nip i Mehmet Aliut të madh, të dy nga Pojari i Korçës ngjitur me Rrëmbecin, fshatin e origjinës së Andromaqit,



Intervista

LAZËR STANI:

Vendimmarrjet e Koliqit nën qeverinë fashiste

Si e zbluam krijimtarinë pas '90-s me shkrimtarin Zija Çela. Fotoja e rrallë në studion e Marubit

■ ■ ■ TIRANE

DHURATA HAMZAI

Takimi për të përkujtuar Ernest Koliqin, shkrimtarin e mirënjohur shqiptar, në 110-vjetorin e lindjes është zhvilluar dje në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në fjalën e tij ministri Zhiti vlerësoi personalitetin krijues dhe kulturor të Ernest Koliqit, që la gjurmë të thella në kulturën kombëtare. "Fenomeni Koliqi i tejkalon vdekjet e veta, atë që është e natyrshme për jetë njerëzish dhe veprash, por dhe ato që ia dhanë plot me mëri, vdekjet si dënim dhe hakmarrje parake. Sipas sentencës latine mund të themi se vepra Koliqiane tashmë i është vënë udhës së ringjalljes e jo vetëm të vetvetes", tha ministri Zhiti. Ministri Zhiti theksoi rëndësinë e jashtëzakonshme të veprës së Koliqit dhe cilësinë e saj të veçantë, gjithashtu. "Koliqi është shkrimtar i klasit të parë, që bashkë me Mitrush Kutelin, janë themelues të tregimit modern në letërsinë shqipe", tha Ministri Zhiti, duke e vlerësuar Koliqin si "një nga emrat më të shquar të letërsisë dhe të kulturës shqiptare së gjysmës së parë të shekullit të njëzetë". Në takimin përkujtimor në nderim të Koliqit foli dhe shkrimtari Lazër Stani, duke vlerësuar gjuhën e tij dhe arrijtjet si dhe studiuesi i ardhur nga SHBA, Mërgim Korça, i cili tregoi për njohjet me shkrimtarin Ernest Koliqi, për porosinë e tij, për vlerat duke treguar se kultura shqiptare është më e pasur me të. Në intervistën për "Shqiptarja.com", shkrimtari Lazër Stani theksoi disa pika kyçe të veprimtarisë së Ernest Koliqit si personaliteti i Kulturës dhe i Arsimit, botuesi i antologjive të para të letërsisë shqipe, të folklorit shqiptar, meritat e përhapjes së Arsimit shqip në Kosovë, ku dhe themeloi të parën shkollë të mesme, etj.

Zoti Stani, çfarë synimi kishte takimi për 110-vjetorin e lindjes së Ernest Koliqit?

"Të sillte në vëmendje të publikut këtë personalitet të veçantë të kulturës shqiptare, i cili ka lënë gjurmë të rëndësishme në historinë tonë kulturore. Ka lënë një trashëgimi të jashtëzakonshme, me të cilën, jo vetëm në vetëdijeshemi, por krijimë edhe vizionin e së ardhmes në projektin e së ardhmes. E thotë Ernesto Sabato, që "një komb matet me



Lazër Stani

njerëzit e shquar". Dhe, padyshim, Ernest Koliqi është një nga njerëzit e shquar të këtij vendi dhe padyshim e them këtë që Ernest Koliqi ka një veprimtari të dyfishtë si krijues, si shkrimtar, i cili me tregimet e tij, me prozën e shkurtër, e ktheu afro tregimin shqiptar me standardet e tregimit evropian që shkroi në vitet '30. Tema e veçantë e Koliqit është njeriu shqiptar, qytetari shqiptar me problemet, me psikikën, me dramën, e me trashëgiminë e tij shpirtërore dhe kulturore. Ndryshe Koliqi qytetërimet e tjera i vë në komfortim, në ballafaqim me modernitetin, me Europën. Dhe kjo e bënë të veçantë në perceptim Koliqin si një shkrimtar. E dyta është se Koliqi përmirësoi teknikën e narracionit. Me tekstin letrar krijoi një trashëgimi. E treta, siç thotë Brockjig, "i vetmi patriotizëm që i

ka hije shkrimtarit të shquar është kur shkruan më një gjuhë të pasur". Koliqi shkruan një gjuhë të begatë dhe kjo tregon se është një patriot i madh i shqipes. Shkrimtari ndihet krenar kur e zotëron gjuhën e tij dhe ai shpreh mes kësaj gjuhë shpirtin e tij, vizionin e tij. Me shumë kolorit dhe në mënyrë shumë ekspresive ai shpreh ëndrën e tij si shqiptar.

Cilat mendoni se janë kontributet më thelbësore të tij, kur dihet që Koliqi ka drejtuar institucionet e vendit nën pushtimin fashist?

"Janë shumë. Koliqin e përkujtuam sot, sepse veprimtaria e tij nuk mbaron vetëm në fushën e kulturës, ku kontributi i tij është shumë i çmuar. Koliqi është autor i antologjisë së parë shqipe. Koliqi është nismëtar i botimit të "Visareve të Kombit", që është pothuajse antologjia e madhe, e plotë e trashëgimisë folklorike të popullit shqiptar, e cila u botua në "Visaret e Kombit". Gjithashtu, Koliqi sa kohë që qe ministër kulture, pavarësisht se ishte në qeverinë e një vendi të pushtuar, u përpoq të shtrinte arsimin shqiptar në të gjitha trevat ku kishte shqiptarë. Me vendimin e Koliqit 200 arsimtarë nga më të zgjedhurit shqiptarë u dërguan në Kosovë dhe përhapën arsimin shqip. Ngritën shkollat shqipe dhe përhapën arsimin shqip, përhapën kulturën shqiptare. Orientimi i Koliqit ka qenë i qartë, shqiptarët janë një popull i lashtë, janë një popull evropian dhe ata duhet të orientohen nga

PËRKUJTOHET 110-vjetori i lindjes së shkrimtarit të shquar shqiptar. Revokohen kontributet e Koliqit si personaliteti i kulturës dhe i arsimit, si botuesi i antologjive të letërsisë shqipe e folklorit



Ernest Koliqi, foto Marubi

Biografi

Ernest Koliqi (1901 - 1975) lindi në Shkodër me 20 Maj 1901, në një familje me origjinë nga Dukagjini. Ishte vëlla me Mikel Koliqin, të parin kardinal shqiptar. Është themelues i tregimit tonë modern, ndërkohë dhe poet, romancier, eseist, përkthyes, gazetar, madje dhe dramaturg.

kultura shqiptare. Ai përkthente për shkollat vetëm letërsi perëndimore, letërsi italiane dhe nxiste shqiptarët që të përkthejnë letërsinë evropiane dhe shqiptarët të edukohen si evropianë. Është hera e parë që falë vendimit të Koliqit u ngrit edhe shkolla e parë e mesme në Kosovë. Është fillesa e punës së tij, që krijoi ato elita intelektuale në Kosovë. Puna e atyre arsimtarëve të shquar që përhapën arsimin shqip bëri që të krijohet elita e ardhshme e Kosovës, të krijohet ajo elitë kulturore kombëtare që çoi në krijimin e një vetëdijeje të fuqishme shqiptare, e cila, në fund të fundit ka sjellë edhe krijimin e asaj Kosovë të pavarur që kemi sot.

Koliqi ka qenë i mohuar, gjatë kohës që ju keni kryer studimet. Kur e keni njohur për herë të parë veprën e Koliqit?

"Koliqi si të gjithë letërsinë e ndaluar shqiptare e kam njohur pas '90-ës, në bashkëpunim me kolegun tim, me mikun tim, Zija Çela. Zijaji po përgatiste një vëllim me tregime të zgjedhura të Koliqit për t'u botuar në në shtëpinë botuese të shkrimtarit në vitin 1993. Atëherë vendosëm që këtë libër me tregime të Koliqit t'i vëmë një titull të ri, "Hanë gjaku", i cili është një nga tregimet më emblematike të Koliqit. Është shumë bukur, asnjë fjalë të tepërt, një tregim mbi një figurë mistike, gati mbi fatin dhe fatalitetin e njeriut.

A mendoni se Koliqi e ka zënë vendin e merituar në letrat shqipe?

"Nuk është vetëm Koliqi, por është një plejadë e tërë e letërsisë sonë, nga letërsia e vjetër shqipe që nuk ka zënë vendin e merituar. Unë e kuptoj se ka një lloj vështirësie për t'u mësuar me këta shkrimtarë si Mjeda, si Fishta, si Mitrush Kuteli. Këta janë diamante që shkëlqojnë, por që dremisin në kulturën shqiptare. Megjithatë nuk janë këta njerëz që humbasin, është kultura shqiptare që humbet.

Universiteti i Arteve

"Ura me Tri Harqe", triniteti i pikturës, teatrit e kinemasë

Në ambientet e Universitetit të Arteve në Tiranë, në Sallën e Madhe, Galerinë FAB, sallën Black Box, duke nisur nga dita e djeshme për të vazhduar edhe sot gjatë gjithë ditës jepet edicioni "Ura me Tri Harqe", që vjen si një histori bashkëpunimi midis institucioneve artistike të Prishtinës, Tetovës dhe Tiranës. "Historia e këtij bashkëpunimi është e gjatë dhe mund të themi me plot gojë se ka qenë e natyrshme dhe e frytshme, jo vetëm në kuadrin institucional, por edhe në realizimin e mjaft



Posteri i ekspozitës që u çel dje

projekteve të përbashkëta artistike e kulturore si dhe në njohjen, ballafaqimin dhe shkëmbimin e eks-

periencave profesionale ndërmjet pedagogëve dhe studentëve të të tre institucioneve. Vlen të theksohet se një pjesë e pedagogëve të Fakulteteve të Arteve në Prishtinë e Tetovë janë diplomuar në Universitetin tonë të cilët, po japin një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe unifikimin në një mënyrë apo tjetër të programeve dhe kurrikulave në shkollat respektive", tha dje për Shqiptarja.com zëvendës-rektori Arben Llozi. Aktiviteti do të jetë i ngjeshur, duke përfshirë

ekspozitën e arteve të bukura, shfaqjen e filmave me metrazh të shkurtër, shfaqjet teatrale, si dhe koncerte e përbashkëta simfonike, me pjesëmarrjen e mbi 100 studentëve dhe pedagogëve nga Tirana, Prishtina dhe Tetova. Mbrëmë në orën 17.00 është çelur ekspozita te galeria "Fab", ndërsa në orën 19.00 u dha shfaqja e teatrit "Pelikani" me autor August Strimberg me regji të Agnes Nokshiqit dhe "Zi e më zi" me autor Kristo Floqin, me regji të Ledian Gjeçit.

Objekti i rrallë

PAS KËRKESAVE të vazhdueshme në adresë të MTKRS, më në fund tryeza shekullore e poetit u dërgua në Institutin e Restaurimit. Arqipeshkvia dhe Famillia e Kuklit bëjnë kërkesë zyrtare për tia rikthyer objektin Kishës...

IRIRI TIRANE

ADMIRINA PEÇI

Ky objekt i rrallë që shihet në fotografi është tryeza e punës së Ndre Mjedës, më shumë se një shekullore, e cila ka shpëtuar për mrekulli, edhe pse peripeçit të shumta e dëmtime të rënda shënohen në historikun e saj. Në këtë tryezë u shkruan poezitë "Vaji i bylbylit", "Shtegtari", "Tringa", "Shkodra", "Lissus", etj. E ndërtuar me një stil artistik të veçantë pasi ka kaluar nga dora në dorë, nga një vend në një vend tjetër, më në fund ajo po restaurohet. Lajmin e bëri të ditur Dom Nikë Ukgjini, duke treguar se pas shumë peripeçish, pas shumë debateve të më parshëm me ish-ministrin e Kulturës Aldo Bumçi e së fundmi me ardhjen e Ministrisë Visar Zhiti, më në fund tryeza 100 vjeçare e Mjedës më 14 maj, 2013, u tërhoq nga Muzeu i Shkodrës, ku qëndroi për 23 vite me radhë e ku pësoi shumë dëmtime serioze për mungesë të restaurimit e kushteve të papërshtatshme të ruajtjes. Tashmë objekti unik ndodhet në Institutin e Restaurimeve në Tiranë ku specialistët po përpicojnë ti rikthejnë shkëlqimin e dikurshëm. Dom Nikë Ukgjini ishte djë në Tiranë për të ndjekur ndërhyrjet restauruese në të dhe njëkohësisht për të bërë kërkesën zyrtare që ky objekt i rrallë të rikthehet në Kishën e Kuklit, pasi është pronë e kësaj kishe.



Tryeza 100 vjeçare e Mjedës



Tryeza e Mjedës në shtëpinë muze të Kuklit 1983



Tryeza e Mjedës në konservim të përkohshëm

Dom Nikë Ukgjini: Shpëtoni tryezën 100-vjeçare të Mjedës

"Po restaurohet pas 23 viteve shkatërrim në depot e Muzeut të Shkodrës. Ti kthehet kishës së Kuklit është pronë e saj"

grisun ndër shumë vende." Gera, duke e njohur vlerën e saj, tryezën punës, në vitin 1959 e çoi në Muzeun e Shkodrës. Këtë dëshmi e rrëfën dhe Vasil Lazari, drejtor i Muzeut Popullor Shkodër, ndërsa shkruar në Almanakun "Shkodra",

viti 1961. Sipas dokumentacionit të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Shkodrës, dt. 12. 01, 1981; dt. 7.02. 1981, flitet për ekzistencën e Shtëpisë Muze në Kukël, i cili qe hapur më 1 gusht 1962, me rastin e 25-vjetorit të

vdekjes së Dom Ndre Mjedës, dhe qe pajisur me tryezën e poetit dhe me fotografi të ndryshme. U mblodhën njerëz nga fshati, erdhën edhe nga Barbullushi, nga lokaliteti i Bushatit. Fjalën e rastit e mbajti inspektori Isa Alibali, ndërsa pas përfundimit,

këshilli popullor organizoi një pritje. Kujdesin për dhomën muze e pati këshilli popullor i fshatit, duke bashkëpunuar ngushtë me muzeun popullor të Shkodrës. Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së poetit, në vitin 1966, dhoma Muze u kthye në "Shtëpi Muze Ndre Mjeda".

Shtëpia Muze e Mjedës u dëmtua rëndë nga tërmeti i 15 prillit 1979. Kështu që në janar dhe shkurt të vitit 1981, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Shkodrës, me propozimin e Seksionit të Arsimit e të Kulturës, vendosi për restaurimin e Shtëpisë Muze. Pas një pune të gjatë, përfurimi u bë me 22 nëntor 1982, ku morën pjesë të gjithë autoritetet më të larta lokale. Edhe me këtë rast si dhe në përfurimin e mëparshëm, në qendër të vëmendjes, qe tryeza e poetit, si objekti më autentik i Mjedës.

Por pas ndryshimeve që ndodhën në vitin 1990, objektet e Shtëpisë Muze, bashkë me to edhe tryeza e punës u kthyen për ruajtje në Muzeun Historik Shkodër, ku edhe qëndroi për 23 vite. Tashmë, siç thotë edhe Dom Nikë Ukgjini, shpresohet që kjo tryezë e poetit të madh të kthehet aty ku ak vendin, në Kishën e Kuklit.

Kërkesa

Aqipeshkvia: Ktheni tryezën e Mjedës është ruajtur në kushte të mjerueshme

Monsinjor Angelo Massafra në emër të Arqipeshkvisë Shkodër Pult dhe Dom Nikë Ukgjini në emër të familjes së Kuklit i kanë drejtuar një kërkesë zyrtare për kthimin e tavolinës së poetit ndre Mjeda Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Tiranë dhe Muzeut Historik të Shkodrës. Në kërkesën që mban datën 16 maj 2013, shkruhet ndër të tjera se "tavolina në fjalë, është ruajtur në kushte të mjerueshme në depon e Muzeut Historik Shkodër për 23 vite më radhë duke mos u ekspozuar fare dhe duke mos e kryer asnjëherë funksionin unik të promovimit të vlerave të rralla të saj, për stilin artistik të ndërtimit dhe ndjesitë kulturore që do të përcillte tek vizitorët.

Muzeu Historik i Shkodrës nuk ka kryer funksionin e tij mbështetur në ligjin nr. 9048 datë 07/04/2003 "Për Trashëgiminë Kulturore" i ndryshuar. Neni 13 "Personat fizike ose juridike që kanë në pronësi objekte të regjistruara më vlera të trashëgimisë kulturore, të luajtshme e të paluajtshme, janë të

detyruar të krijojnë kushte mirëmbajtjeje për këto objekte". Neni 16 pika 1. "Institucionet e specializuara shtetërore, në marrëveshje me pronarët dhe zotëruarit e objekteve të trashëgimisë kulturore, krijojnë kushte për ekspozimin e këtyre objekteve për publikun".

Kërkesën për kthimin e tryezës në vendin e origjinës, Kisha e Kuklit, Arqipeshkvia Shkodër e mbështetet dhe në Urdhrin nr 264 datë 25 /07 /2012 lëshuar nga ministri Aldo Bumçi i cili për tavolinën e Mjedës nder të tjera shpreh



Faksimile e kërkesës për kthimin e tryezës së Mjedës si pronë e kishës

"për kompletimin e Monumentit të Kulturës, Kompleksi Ndre Mjeda Kisha-Cele të restaurohet pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës tavolina e punës së Ndre Mjedës".



Ergys Kaçe

Kombëtarja

Kaçe: Pres me padurim fitoren kundër Norvegjisë

Bindja e Ergys Kaçes për të luajtur me ekipin kombëtar të futbollit duke refuzuar njëherë edhe përgjithmonë Greqinë është një triumf me shumë mund i arritur nga FSHF pas largimeve të Kones dhe Ninitis në Greqi, por edhe Kabashit në Itali. Suksesi për afrimin e Kaçes ka lehtësuar paksa dhimbjen e kokës për trajnerin De Biasi, i cili për ndeshjen më krye-

sore të tij me Shqipërinë duhet të bëjë pa shumë futbollistë cilësore duke filluar nga kapiteni Cana, Meha, Kukeli, Roshi, por edhe Lila që po shkëlqen në Greqi në këto momente. Megjithatë Kaçe duke se është blerja e duhur për t'i dhënë një odrë suksesit ndaj nordikëve më 7 qershor në Tiranë. Pas pranimit të ftesës në kombëtare ka reaguar për herë të parë edhe vetë

futbollisti me origjinë nga Korea duke deklaruar se mezi pret që të zbrësë në fushë për këtë ndeshje. Në faqen e tij zyrtare në rrjetin social 'Facebook' mesfushori me tipare mbrojtëse dhe organizator i spikatur në mesfushë, ose më saktë një futbollist alla Prilo shprehet se pret me padurim datën 7 qershor "Do të luaj ndaj Norvegjisë, dëshira ime më e madhe është t'i u-

kthej ngazëllimin e Oslos, Tifozave Kuq e Zi. Në atë moment ku Hamdi Salhi na ngriti në këmbë të gjithëve, i cili është i paharrueshëm për të gjithë. Dua të kontriboj për një fitore kundër Norvegjisë" shkruan mesfushori në faqen e tij. 161 Cm i gjatë është Ergys Kaçe. Do të jetë futbollisti më i shkurtër i Kombëtares, pasi deri më sot atë rol e mbante Hyka, me 168 cm.

Perez: Vendosëm të ndërpresim bashkëpunimin

Murinjo shkarkohet për herë të parë

'Special One' te Çelsi, Ançeloti te madrilënët

Lajmi

Presidenti i Realit të Madridit, Florentino Perez pas një mbledhje me bordin drejtues vendosi shkarkimin e trajnerit portugez, pavarësisht se në komunikatën për mediat deklaroi se tekniku nuk ishte shkarkuar, por ishte arritur një marrëveshje për largimin e tij nga Reali.

SPANJE
DYLBER BALLA



Presidenti i Realit, Perez dhe ish-trajneri, Hose Murinjo

Edhe 'Special One' e ka një fund. Hose Murinjo për herë të parë në karrierën e tij është shkarkuar pas një epoke të suksesshme në tre ekipet e fundit që kishte drejtuar në karrierën e tij profesionale. Presidenti i Realit të Madridit, Florentino Perez pas një mbledhje me bordin drejtues vendosi shkarkimin e trajnerit portugez, pavarësisht se në komunikatën për mediat deklaroi se tekniku nuk ishte shkarkuar, por ishte arritur një marrëveshje për largimin e tij nga Reali. Por e vërteta qëndron se pas shumë divergjenceve me futbollistët, drejtuesit, tifozët, mediat dhe padyshim arbitrat, Murinjo është larguar përfundimisht nga gadishulli iberik. Murinjo në karrierën e tij nuk është shkarkuar në këtë mënyrë, pasi te Porto është larguar si hero pas fitimit të Champions League, e njëjta gjë edhe kur drejtonte ekipin e Çelsit, pasi e mori nga asgjëja këtë ekip dhe e ngriti në majën më të lartë të futbollit anglez. Përsëri te Interi fitoi besimin e drejtuesve dhe zemrat e tifozëve, pasi riktheu Champions League pas shumë e shumë vitesh mungesë. Por te Reali ishte ndryshe, dhe jo më kot cilësohen si 'Mbretërit', pasi kapricit e Murinjos nuk gjetën jehonë në Spanjë. Në tre edicione fitoi vetëm një herë La Ligën dhe Kupën e Mbretit dhe një herë Super Kupën e Spanjës. Ëndrra për Championsin e 10 mbeti në sirtar për

madrilenët dhe Perezin që investoi fuqishëm, pasi në tre edicione Murinjo dështoi në gjysmëfinale përballë Barcelonës, Bayernit të Mynihut

dhe Borussia të Dortmundit. Ky edicion ishte më i keq, pasi nuk mori asnjë trofe, humbi edhe finalen e Kupës së Mbretit në fundjavë. Një nga shkaqet


e largimit ishin divergjencat e mëdha me Casillas, legjendën e Realit, këtë fakt nuk ia falën tifozët, por edhe drejtuesit. Nëse Murinjo nuk do të lar-

Karriera

Murinjo në karrierën e tij nuk është shkarkuar në këtë mënyrë, pasi te Porto është larguar si hero pas fitimit të Champions League, e njëjta gjë edhe kur drejtonte ekipin e Çelsit, pasi e mori nga asgjëja këtë ekip dhe e ngriti në majën më të lartë të futbollit anglez dhe Interit.

gohej në fund të edicionit, atëherë ishte Casillas ai që do të largohej nga Reali. Por drejtuesit vendosën të kundërtën. Kështu portugezi i lë vendin e tij italianit Carlo Anceloti, i cili braktisi PSG për të drejtuar 'Galaktikët'. Ndërsa Murinjo do të shkojë në Angli për të drejtuar Çelsin e Londrës.

Finalja



Një italian gjykon gjermanët në Angli

Nicola Rizzoli është zgjedhur nga UEFA për të drejtuar finalen e Ligës së Kampioneve mes Borussia të Dortmundit dhe Bayern Mynihut. Në vitin 2010 Rizzoli drejtoi finalen e Europa League, ku Atletico Madrid mundi Fulham në Hamburg të Gjermanisë. Në "Euro 2012" ka gjykuar 3 ndeshje, ndërsa në Champions League ka qenë arbitër kryesor në 26 takime. Ndihmësit e italianit në finale do të jenë anësorët Renato Favarani dhe Andrea Stefani. Arbitër i katërt do të jetë sloveni Damir Skomina. Arbitrat e portës do të jenë italianët Gianluca Rocchi dhe Paolo Tagliavento.

Sugjerimi

De Biasi këshillon Lazion, Hysaj cilësor dhe me shumë perspektivë



Trajneri i Kombëtares, De Biasi nuk i kurseu vlerësimet për trajnerin Petkoviç, i cili e ka kuptuar se Cana mund të japë kontribut më të madh në mbrojtje. De Biasi komentoi edhe mundësinë e transferimit të Hysajt nga Empoli te Lazio, duke e cilësuar 19-vjecarin një lojtar me shumë perspektivë. Hysaj është një futbollist më shumë cilësor, ka forcë fizike dhe vrapon shumë. Është vetëm 19 vjeç, por ka rënë në sy te Empoli. Besoj se nëse Lacio arrin ta marrë, do të bënte shumë mirë, sepse po flasim për një lojtar me shumë perspektivë. De Biasi e mbylli prononcimin e tij me një vlerësim për ekipin e Lazios. Prej disa vitesh Lazio po zhvillon kampionate me nivel shumë të lartë, duke patur kënaqësinë e fitimit të Superkupës dhe Kupës së Italisë, ndaj besoj se për këtë arritje duhet vlerësuar përfundon De Biasi.

Champions League

Njeriu i 4 finaleve të humbura Roben: Në 'Uembli' fiton Bayern




Njeriu që ka humbur më shumë finale, Arjen Roben është i bindur se do të fitojë Ligën e Kampioneve më 25 Maj në 'Uembli'. Lojtari holandez është një nga më të paafatët e finaleve të mëdha pasi ka humbur dy herë me Bayernin e Mynihut ndaj Interit dhe Chelseat në Champions League, një finale të Kupës së Gjermanisë, por edhe një finale të Kupës së Botës me kombëtaren e tulipanëve. "Do vijë dita që gjërat do të shkojnë në drejtimin e duhur edhe për mua në një finale. Kam ndjesi pozitive që kjo do të ndodhë këtë herë. Duhet të ruajmë formën tonë dhe të udhëtojmë me besim të plotë drejt Anglisë. Ky është viti i Bayernit të Mynihut dhe këtë do të kurorëzojmë më së miri në 25 Maj" deklaroi Roben. Ndërsa përsa i përket të ardhmes pas mbërritjes së Guardiols, Roben u shpreh se nuyk do të largohet nga Bayerni i Mynihut.

PARADE FJALEKRYQESH

NIGIA Kadri Vokopola



FJALEKRYQI SPORTIV



HORIZONTAL

- Josta trainer.
- Eshtë sportiv me Sport Ekspres.
- Alianz në stadiumin e Bayern.
- Eshtë vota në favor.
- Eshtë tokë e punëshme.
- Një nigglet në NBA.
- Initiallet e Cage aktor.
- Një garë në hipodrom.
- Institucione Doganore Sarandë
- Kwadwo të Juventus.
- Një sportist si Michael Phelps.
- Personazhi në foto.
- Xhelilaj aktor.
- Personazhi në foto.
- Fillojnë poshtë.
- Skuadër braziliane.
- Organizma Rajonale Has.
- Diftong në teori.
- Të parat në stafetë.
- David të Bayern.
- Një mundeësi... shërimi.

VERTIKAL

- Sharapova teniste.
- Mirë në qendër.
- Kështu thirren lojtarët e Liverpool.
- Pak energjike.
- Luanjë pa ujë.
- Në krye të tabelës.
- Skuadër italiane.
- Eshtë djalosni.
- Skuadër italiane.
- Eshtë... me tokën një gjuajje... tokazi.
- Eshtë yll i skuadrës.
- ...da Gama skuadër braziliane.
- Kështu quhet ndryshe boksi.
- Dunga trainer brazilian.

HORIZONTAL

- Janë të dërguar speciale
- Ato të përqëndrimin janë të tmerrshëm.
- Janë publikë si barut.
- Takime Sportive Lokale
- Rralle është përgjysmë.
- Eshtë mister.
- Janë pjesët e hekurta.
- Fillojnë një meeting
- Drejtohen për të bërë zoom.
- Një koleg i famshëm anglez.
- Eshtë linja për... të folur.
- King Cole i muzikës.
- Janë ata që qënjëjnë për t'u bërë të famshëm.
- Një pjesë e shtarqit.
- Në krye të trupave.
- Eshtë fëmijë.
- Fund filmi.
- Zanore ahengu.
- Gjysmë rakete.
- Janë sportive të tilla të Alban Xhihanit.
- Ora këngëtare.
- Kështu filon numërimi.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT SPORTIV



FJALEKRYQI PA SKEME

DUHET TË NXINI 33 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	
1																		
2																		
3																		
4																		
5																		
6																		
7																		
8																		
9																		
10																		
11																		
12																		


HORIZONTAL

- Janë të dërguar speciale
- Ato të përqëndrimin janë të tmerrshëm.
- Janë publikë si barut.
- Takime Sportive Lokale
- Rralle është përgjysmë.
- Eshtë mister.
- Janë pjesët e hekurta.
- Fillojnë një meeting
- Drejtohen për të bërë zoom.
- Një koleg i famshëm anglez.
- Eshtë linja për... të folur.
- King Cole i muzikës.
- Janë ata që qënjëjnë për t'u bërë të famshëm.
- Një pjesë e shtarqit.
- Në krye të trupave.
- Eshtë fëmijë.
- Fund filmi.
- Zanore ahengu.
- Gjysmë rakete.
- Janë sportive të tilla të Alban Xhihanit.
- Ora këngëtare.
- Kështu filon numërimi.

VERTIKAL

- Kështu është gabimi më i thjeshtë.
- Initiallet e Eluard.
- Janë vlerat me para.
- Një pjesë e memories.
- Institucione Kombëtare Informatve.
- Fundci i Turandot.
- Janë male në Rusi të tilla.
- Françoise që shkroi Bonjour tristesse.
- Mitet pa kufij.
- Emër vajze
- Mia që qe këngëtare italiane.
- Chris këngëtar
- Stilet pa set.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT PA SKEME



I KRIPTOGRAFUAR

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

1	H	6	A	R	11	K	16		3			11	2	11
6	3	9			5	9	8	2	12	6			6	6
4	2	5	5		13	9	4		13	2		15		
6	12		6	16	7	13	9	12	6			2		
3	7		1	7	8	6	10	2	8	6	10			
7		1	6	3	6	12	7	4	6		6			
13		7	4	6						6		9	10	
6	4	3	9	10	7	4				11	14			
10	6	4	6		3	9	14			6	4	10		
11	6	12	10	9	12	6				13	7	6		
6		9	6	14		2	4	6		6	4			
15	6	11			3	4	6	16			13	7		

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

V	E	N	D	S	F	T	I	N	A
R	O	T	T	I	V	D			
G	I	T	H	O	N	O	R	A	R
A	K	M	O	N	O	T	O	N	E
R	M	O	L	E	K	U	L	A	R
D	R	I	T	A	R	E	I	A	I
A	L	L	E	N	T	S	H	S	
G	I	L	D	A	P	R	U	S	H
V	T	I	A	K	O	T	I	P	
R	E	A	K	E	T	I	R	A	
A	N	I	V	E	N	A	M	T	
P	E	T	E	R	D	A	F	I	N

HOROSKOPI



DASHI
Fale konfigurimit të yjeve, sot do kaloni nga njëra surprizë tek tjetra, por edhe nga një debat tek tjetër. Beqaret do kenë me shumë fat se të gjithë dhe do takojnë me në fund princin e tyre të kaltër. Në planin financiar mos harroni të shihni njëherë buxhetin para se të shpenzoni.



LUANI
Edhe pse keni kohë që jeni në një lidhje dhe mendoni se e njihni mirë njëri-tjetrin, ka gjithmonë disa limite që nuk duhen tejkaluar. Mos e prekeni atë që keni në krah atje ku i dhemb me shumë. Beqaret që do shkojnë jashtë qytetit të tyre ka gjasa të takojnë një person të veçantë.



SHIGJETARI
Jeta në çift do jete shumë e thjeshtë gjatë kësaj dite, por edhe pa emocione të mëdha. Merrni gjerat si t'u vijnë pa menduar mbi të ardhmen. Në planin financiar do keni fat, megjithatë nuk duhet të shpenzoni shumë të mëdha për gjera pa vlerë të rëndësishme.



DEMI
Në planin sentimental të çifteve do ketë përmirësime të ndjeshme gjatë kësaj dite. Partneri do iu kuptojë me shumë dhe do iu japë gjithë ngrohtësinë që dëshironi. Beqaret fale dëshirës se tejkajshme për të pasur takime mund të bëjnë disa gabime në zgjedhje.



VRGJËRËSHA
Ka shumë mundësi që sot të qëndroni larg partnerit tuaj dhe të reflektoni me kujdes mbi ato që do bëni në të ardhmen. Do i kuptoni edhe disa gabime që keni bërë. Për beqaret dita do jete si gjithë të tjerat dhe nuk do ketë surpriza të mëdha. Bani pak me tëpër durim!



BRICJAPI
Dielli dhe Venusi do e bëjnë ditën edhe më të bukur për gjithë të dashuruarit. Do iu kaloni mire pranë atij që keni në krah dhe do fillojë për gjithë. Një pjesë e beqareve do kenë takime për të cilat do iu rrahe zemra fort. Financat do kalojnë një periudhë të veshtrë.



BINJAKET
Çiftet do gjenden përballë një dileme të vështirë. Merrni kohë e duhur për t'u menduar dhe për të bërë zgjedhjen e duhur. Venusi do i beje beqaret joshës dhe të parrezistueshem sot. Mundësitë për ta gjetur personin ideal do jete të mirëkullueshme. Shitrytëzohini!



PESHORJA
Do jeni me romantike se me parë sot dhe do përjetoni me shumë emocione. Do filsi me të vërtetat dhe nuk do tregoheni aspak të pamatur. Beqaret do jete të fillonjë aventura afatshkurta vetëm që të përjetojnë emocione. Një lidhje serioze nuk ehte ende në mendjen e tyre.



UJORI
Te gjithë planetët do jete të pozicionuar mire sot në jetën tuaj në çift. Gjithçka do shkoje sipas parashikimeve dhe zemra do rrahe me shpejt. Për beqaret gjithçka do ndodhe si me magji. Në ndonjë moment do iu duket vetja sikur jeni në një film romantik.



GAFORRJA
Konfigurimi i yjeve do jete mjaft pozitiv gjatë kësaj dite për jetën tuaj në çift. Fati do iu buzëqeshë dhe do iu kaloni me se miri në praninë e atij që dashuron. Në planin financiar edhe pse me shumë vështirësi do arrihi t'i bëni balë tundimit dhe të shmangni shpenzimet e mëdha.



AKREPI
Marrëdhënia në çift ka shumë gjasa të përmirësohet gjatë kësaj dite. Do ndiheni me të afërt me njëri-tjetrin dhe do bashkëpunoni mjaft. Beqaret do jete të parrezistueshem dhe do marrin propozime të shumta. Përfiton nga ky fakt për të bërë zgjedhjen e duhur.

SUDOKU

	9							8	
6	5		2	1				3	
1	3		8				5	7	
9			5	4	6				8
5	8	1		3	6				9
3			2	9	8				5
7	6		1					3	2
8	3		6		9				1
1								6	

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

5	3	1	6	7	9	8	4	2
4	9	7	2	8	1	6	5	3
2	8	6	3	5	4	1	7	9
8	2	3	5	1	7	9	6	4
1	7	9	4	2	6	3	8	5
6	5	4	9	3	8	7	2	1
7	4	5	1	6	3	2	9	8
9	1	8	7	4	2	5	3	6
3	6	2	8	9	5	4	1	7

**LAJME
NGA BOTA**

■ Greqi, neonazistët kërcënojnë islamikët

Neonazistët grekë kanë kërcënuar komunitetët mysliman në Greqi se do të "theren si pula, nëse nuk emigrojnë nga Greqia". Sipas pohimeve të gazetës "Greek Reporter", në letër që neonazistët grekë i kanë dërguar Bashkësisë Islame në Greqi, ka kërcënime për myslimanët në Greqi që deri muajin e ardhshëm të largohen nga vendi. "Vrasës myslimanë, nëse deri më 30 qershor nuk i mbyllni bordellot tuaja në Greqi, do t'iu dërgojmë në ferr", thuhet në letër, të shkruar në anglisht, greqisht dhe arabisht. Komuniteti Islamik do të kërkojë prej qeverisë greke që të gjithë qytetarëve t'iu sigurojë të drejta dhe liri të njëjta dhe që myslimanët të mos jenë viktimë të partive ekstreme politike.

■ Ministri i Jashtëm gjerman vizitë në Beograd

Ministri i Jashtëm gjerman, Guido Westerwelle, është takuar në Beograd me presidentin e Serbisë, Tomislav Nikoliç. Westerwelle ka thënë se pret që Serbia, së shpejti, të marrë datën e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, por ka theksuar edhe rëndësinë e zbatimit të marrëveshjes me Kosovën. Nikoliç ka thënë se Serbia është e përkushtuar në zgjidhjen e problemit të Kosovës dhe në përparimin e mëtejshëm drejt BE-së, por ka thënë se nuk do të mashtrojë partnerët evropianë, duke premtuar diçka që nuk mund të përmbushë. Sipas medias serbe, në këtë mënyrë ai ka vënë në pah se Serbia nuk do të njohë kurrë pavarësinë e Kosovës.

■ Arrestohet djali i kryeparlamentarit maqedonas

Media greke bëri të ditur se më 30 prill është arrestuar në Greqi djali i kryetarit të Parlamentit të Maqedonisë Trajko Velianoski. Arrestimi i 20-vjeçarit Filip Velianoski, i cili ndodhej në Greqi për të festuar Pashkët, u bë sepse, gjatë kontrollit, në bagazhin e makinës së tij u gjet një sasi droge dhe një thikë. Ai pohoi në prokurori se droga ishte e destinuar për përdorim personal dhe se nuk e dinte që në Greqi kërkohet leje nga policia për mbajtjen e një thike. Nuk është hera e parë që femijet e Velianoskit krijojnë probleme për babanë e tyre. Në fillim të vitit, fotot sensuale, që vajza e tij 23-vjeçe postoi në Instagram, u bënë tituj kryesorë në median vendase.

■ Rusi, atentatë terroriste në Dagestan

Rusia është tronditur sërish nga shpërthime me autorë grupet terroriste, që kanë pasur këtë herë në shënjestër rajonin e Dagestanit. Nga shpërthimi i dy makinave në qytezën e Mahaçkalasë, në Kaukazin Verior, kanë mbetur të vrarë tetë persona dhe më shumë se 20 të tjerë mbetën të plagosur. Lajmin e ka bërë të ditur policia, e cituar nga agjencia e lajmeve Interfax. Dagestani është përfshirë nga një mungesë e theksuar sigurie vitet e fundit, si rrjedhojë e përplasjeve midis forcave ruse të sigurisë dhe militantëve islamikë që kërkojnë të themelojnë një shtet të pavarur.

■ Franca, vendi më shumë turistë në botë

Vendi më i vizituar nga turistët në botë është Franca, të cilën gjatë vitit të kaluar e kanë vizituar 81.4 milionë vetë. Në vendin e dytë janë SHBA-të me 62.7 milionë turistë dhe pas tyre radhiten Kina, Spanja, Italia, Turqia, Britania e Madhe, Gjermania, Rusia e Malajzia, që përbëjnë 10 superfuqitë turistike botërore. Në rajonin e Ballkanit, Kroacinë e kanë vizituar 9.9 milionë turist, të cilët kanë shpenzuar 9.6 miliardë euro, me një mesatare prej 2.240 dollarësh për banor të vendit. Që janë mjetet marramendëse në krahasim me disa vende tjera, ndërsa kur në këtë kontekst përmendet Maqedonia, ajo as që përfshihet në këto lista statistikore.



Kalo në Abissnet pa ndryshuar numrin dhe përfito avantazhet e telefonisë tonë fikse

▶ 2000 lekë kohë bisedë dhuratë

▶ 0 lekë tarifë fikse mujore

▶ Çmimet deri -70% më lirë

+ 1 muaj internet falas nëse lidh edhe internetin.



www.abissnet.al



tërheqja e prezistueshme e lirisë

• Alba Malltezi
Drejtoresh e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtoresh e Shqiptarja.com

• Edmond Arizaj
Kryeredaktor

• Genc Kondi
Zv.Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena

Aktualitet: Granit Sokolaj
Ekonomia: Genc Kondi
Social: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli

Website: Suela Gera

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
cel: +355696060418
cel: +355696088847

Redaksia: Rruga "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë